

NËN KUJDESIN E
PAOLO RAGO
VITET E ULJES SË TENSIONIT

BOTIMET TOENA

Nën kujdesin e
PAOLO RAGO

VITET E ULJES SË TENSIONIT

MARRËDHËNIET ITALIANO-SHQIPTARE
NË FAZËN KULMORE TË LUFTËS SË FTOHTË

BOTIMET TOENA
TIRANË

Questo libro é stato pubblicato con il contributo del Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale italiana.

Ky libër u publikua me kontributin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Kooperacionit italian.

Titulli në original: Gli anni della distensione. Le relazioni italiano-albanesi nella fase centrale della Guerra fredda
Botoi në italisht: Editori Laterza

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

Përkthim i Diana Çulit për esetë e autorëve: Alberto Basciani, Ylber Marku dhe Nicola Pedrazzi, Luca Micheletta, Paolo Rago, Luca Riccardi, Settimio Stallone.

ISBN 978-9928-376-53-4

© Ambasciata d'Italia a Tirana

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjetei apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

Hyrje

Në përmbyllje të fazës së parë kërkimore, mbështetur nga ambasada italiane në Tiranë në kuadër të një projekti trevjeçar mbi studimin e marrëdhënieve dypalëshe gjatë viteve të Luftës së Ftohtë, në vitin 2017, u botua përmbledhja *Paqja e nevojshme. Marrëdhëniet italiano-shqiptare në fazën e parë të Luftës së Ftohtë*, mundësuar nga kontributet e studiuesve nga të dyja vendet, të cilët e kryen punën e tyre kërkimore në arkiva të ndryshme shqiptare e italiane, si edhe në Departamentin e Shtetit në Uashington e në *Foreign Office*. Kjo fazë e parë pune u pasua nga një e dytë gjatë vitit 2018, ku morën pjesë aktivisht, si edhe në fazën e parë, studiues nga të dyja vendet. Duke ndjekur analizën e mëparshme, kjo fazë e dytë kërkimore u thellua edhe më tej në marrëdhëniet dypalëshe dhe u përqendrua në mënyrë të veçantë mbi periudhën e mesme të viteve të Luftës së Ftohtë, e më saktësisht, në periudhën midis viteve 1961 dhe 1978. Për këtë arsye, vëllimi që po marrim në dorë: *Vitet e uljes së tensionit. Marrëdhëniet italiano-shqiptare gjatë periudhës së mesme të Luftës së Ftohtë*, është pa dyshim një zgjerim i natyrshëm i atij të mëparshmit.

Motivet, mbi të cilat bazohet kjo ndërmarrje e re kërkimi shkencor, janë kërkimi dhe studimi i mëtejshëm i kompleksitetit të marrëdhënieve mes dy vendeve në një periudhë aspak të lehtë, të karakterizuar nga antagonizmi i papajtueshëm ideologjik, i ushqyer kryesisht nga ana e qeverisë së Tiranës, ndonëse mjaft më i zbutur në krahasim me periudhën pesëmbëdhjetëvjeçare, të shqyrtuar më parë. Kështu, zgjidhja përfundimtare e disa çështjeve thelbësore, si ajo e reparacioneve të dëmeve të luftës dhe rikthimi i shumëpritur në atdhe i italianëve, të mbajtur në Shqipëri në përfundim të konfliktit botëror në një regjim gjysmëburgimi, pa dyshim ndihmuan për të ulur tonet e ashpra mes dy vendeve, eksponente të dy botëve absolutisht të papajtueshme. Afrimi i ofruar, e madje dhe ai bashkëpunim i mangët, së tepërmi i kufizuar

në pak sektorë dhe fusha të përcaktuara nga pala shqiptare, gjithsesi mundën të shënonin hapjen e një faze të re politike, që do të sillte ndihmesë në arritjen e një ekuilibri më të qëndrueshëm në zonën e Mesdheut Qendror.

Prandaj, për të njohur më gjerë një periudhë kohore, pa dyshim mjaft të pasur, e cila gabimisht gjykohet rëndom si pa ndonjë farë kuptimi, shpesh edhe e parëndësishme për studimet historiografike, u mendua se do të ishte me dobi të vazhdohej studimi kërkimor i nisur disa vjet më parë, ku u shpalosën, si edhe pritej, fakte me interes të madh, që meritonin të viheshin domosdoshmërisht në dukje, duke vërtetuar në të njëjtën kohë nuhatjen fillestare për rëndësinë e këtij studimi.

Për sa i përket përpunimit të këtij punimi të dytë, studiuesit e tjerë që dhanë kontributet e tyre për ta realizuar, së bashku me studiuesit e përfshirë që në fazën e mëparshme, i zhvilluan kërkimet e tyre në po ato institucione arkivore që përmendëm. Më pas ata përfunduan studime të përshtatshme e të nevojshme për të hedhur dritë mbi aspekte të ndryshme të marrëdhënieve dypalëshe, që patën njëfarë suksesi, me gjithë ndryshueshmërinë e vazhdueshme të qëndrimeve, si e përmendëm më lart.

Profesor Settimio Stallone, në *Università degli Studi di Napoli Federico II*, ka analizuar në thellësi periudhën kohore mes viteve 1961 e 1976, duke u ndalur më shumë në studimin e historisë së marrëdhënieve politiko-diplomatike mes Romës e Tiranës. Pasi u kapërcyen përfundimisht çështjet kryesore të reparacioneve të luftës dhe të kthimit në atdhe të qytetarëve italianë, ushtarakë e civilë, që mbaheshin në Shqipëri pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, marrëdhëniet zyrtare disi më të zbutura gjetën një kanalizim më të vendosur për rritjen e mëtejshme të shkëmbimeve tregtare. Mbarëvajtja e tyre solli si rrjedhojë një proces progresiv uljeje tensioni, që mbështeti lindjen dhe përforcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, brenda një kuadri gjithsesi të paqëndrueshëm të politikës ndërkombëtare.

Profesor Luca Micheletta, në *Sapienza Università di Roma* u ndal në periudhën e përkohshme që fillon me pushtimin e Çekosllovakisë (1968) e deri në mospjesëmarrjen e Shqipërisë në sistemin e sapolindur të sigurisë CSCE (1975).

Në ato vite diplomacia e Romës punoi paprerë, por, për fat të keq, më kot, për të bindur Tiranën mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë organizëm të ri. Ky hap mbështetej jo vetëm nga Italia, por edhe nga Jugosllavia dhe Greqia, si element themeltar për ruajtjen e sigurisë në Mesdhe dhe si garanci për largimin përfundimtar të BRSS-së nga kjo zonë, pranisë kërcënuese të të cilit i druhej pa masë edhe udhëheqja shqiptare, si pasojë e prishjes së saj përfundimtare me Moskën në vitin 1961.

Profesor Alberto Basciani, në *Università degli Studi Roma 3*, shqyrtoi orvatjet e shumta të ndërmarra nga Italia në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë, në shumicën e rasteve të pafrytshme, të cilat synonin hapjen e kanaleve të tjera të bashkëpunimit me regjimin e Tiranës përmes marrëdhënieve kulturore. Por, nga pala shqiptare kjo perspektivë mbeti e ngrirë, të paktën deri në fund të viteve gjashtëdhjetë, edhe për shkak të mosmarrëveshjes lidhur me praninë e një numri jo të vogël mërgimtarësh antikomunistë shqiptarë në tokën italiane. Megjithëse kjo çështje, në vija të përgjithshme, u kapërcye nga mesi i atyre viteve dhe megjithëse marrëdhëniet e ndërsjella kishin arritur një ekuilibër më të madh, qeveria shqiptare vazhdoi të mos hapte rrugë ndaj kësaj perspektive nga frika e përhapjes së ideologjive “borgjeze” apo antikombëtare. Nga ana tjetër, politika italiane priste kohë më të mira, por pa lënë pas dore edhe bashkëpunimin në disa veprimtari më të vogla (si për shembull dhënien e bursave të studimit për studentë të universitetit) duke synuar të mos shuhej përfundimisht shpresa e një evolucioni të ardhshëm të marrëdhënieve të ndërsjella.

Profesoreshë Nevila Nika, rektore e *Universitetit European* të Tiranës, ka analizuar ndryshimin e ndodhur përgjatë viteve si pasojë e evolucioneve politike të brendshme dhe atyre ndërkombëtare, mes qëndrimeve që mbanin Partia Komuniste Italiane dhe ajo e Partisë së Punës së Shqipërisë. Ndonëse u vu re një mirëkuptim i periudhës së pasluftës mes këtyre dy formacioneve komuniste, ai u zbeh pas vdekjes së Stalinit dhe ngritjes së mëtejshme në pushtet të Nikita Hrushovit, autor i të ashtuquajturës “politikë e destalinizimit”. Udhëheqja shqiptare e pa këtë situatë si një rrezik

për mbijetesën e saj, kështu që, pa dyshim, kjo politikë shënoi një shkëputje në kontekstin ndërkombëtar që solli, mes të tjerash, një ngurtësi gjithnjë edhe më të fortë të Enver Hoxhës në qëndrimet e tij si rojtar i komunizmit të palëkundshëm botëror. Dhe Shqipëria nuk vonoi ta prishte miqësinë, gjithnjë të mundimshme, me Palmiro Togliatti-n dhe, në vitet që pasuan, nuk ngurroi as të rrëzonte urat me sekretarin e ri të PKI-së, Enrico Berlinguer-in, përfaqësues i një vizioni të ri në marrëdhëniet me BRSS-në, duke e akuzuar rëndë si revizionist dhe armik të komunizmit.

Profesoreshë Sonila Boçi, anëtare e Akademisë së Studimeve Albanologjike të Tiranës dhe doktor Nicola Pedrazzi, gazetar, publicist, bashkautor me profesor Ylber Markun, studiues në *Universitetin e Hsianmenit* në Kinë, kanë përshkruar procesin e ndërsjellë të afrimit që u vërejt në vitet gjashtëdhjetë mes Partisë së Punës së Shqipërisë dhe Partisë Marksiste-Leniniste të Italisë. Të dy kapitujt shqyrtojnë të njëjtën temë, duke marrë secili në konsideratë mjedisin shqiptar dhe atë italian e duke vënë në dukje veçoritë e të dyve. Duke analizuar objektivat politike, që të dyja këto forca synonin të ndiqnin për t'i dhënë jetë idealeve të tyre, në fakt paralele, por që përkonin vetëm në aspektin përbashkues të përkatësisë në një ideologji politike rreptësisht marksiste, kontributet e të tre studiuesve përpiqen të zbërthejnë një situatë ndoshta të padëgjuar më parë në të gjithë politikën ndërkombëtare. Kërkimi për një mbështetje të jashtme, përveç asaj kineze, e cila i dha partisë së Enver Hoxhës mundësinë të rriste numrin e mbështetësve të regjimit të tij - në këtë rast në Itali - dhe të arrinte një peshë politike ndërkombëtare nga ana e grupit jashtëparlamentar italian, i cili papritur doli përtej perspektivave të dobëta kombëtare dhe krijoi mes të dyja forcave një aleancë të pabarabartë dhe krejtësisht *sui generis*. Megjithatë, ajo rezultoi funksionale dhe, të dyja grupimet, së bashku me Kinën e Mao Ce Dunit, mundën të gjenin, ndonëse për një kohë të kufizuar, një projektim të tyrin politik në kontinentin evropian.

Profesor Luca Riccardi, në *Università degli Studi di Cassino e del Lazio Meridionale*, duke analizuar kryesisht dokumentacionin e depozituar në MAE, që lidhej së shumti me përndjekjet dramatike

që kryheshin në Shqipëri ndaj besimeve fetare, hedh dritë në një aspekt të veçantë të regjimit komunist të Tiranës, pak i studiuar deri sot, përmes një analize historike të thelluar e të kujdesshme. Një veçanti e regjimit komunist shqiptar ishte persekutimi i egër që ushtrohej mbi besimet fetare, të cilat ekzistonin historikisht në Shqipëri. E filluar në vitin 1945, politika e ashpër e shtetit të ri komunist kundër fesë veptoi gjatë dy dekadave me faza të ndryshme e të përkohshme dhe me marrjen e masave të shumta. Megjithëse në krye dukej sikur e ruajti formalisht pavarësinë e çdo besimi fetar, në të vërtetë, ajo përfundoi duke kufizuar gjithnjë e më shumë lirinë e kulteve dhe lirinë individuale të klerit dhe të besimtarëve të thjeshtë të feve të ndryshme. Më pas, në valën e revolucionit kulturor kinez, Hoxha, në vitin 1967 vendosi t'i jepte përfundimisht fund “mbeturinave të besëtytnive”. Përmes një “fushate veprimi të rinisë” u mbyllën fizikisht shumë vende kulti dhe gjithashtu u burgosën një numër i madh besimtarësh e klerikësh, derisa, në Kushtetutën e vitit 1976 u fut koncepti i ateizmit shtetëror; që as Bashkimi Sovjetik nuk kishte guxuar të ndërmernte një masë të tillë.

Së fundmi, profesor Edon Qesari, i *Universitetit Mesdhetar* të Tiranës, ka marrë në shqyrtim praninë në Itali të të larguarve antikomunistë shqiptarë, mes të cilëve nuk bënë pjesë vetëm ish-bashkëpunëtorët e regjimit fashist, të larguar nga vendi i tyre sapo pushteti ra në duart e Hoxhës, por edhe mbështetës të ideologjive të ndryshme politike. Të emigruar matanë Adriatikut, ata krijuan një numër të konsiderueshëm shoqatash, shpesh në kundërshti me njëra-tjetrën për objektivat që duhej të ndiqnin, por që përgjithësisht kishin për qëllim rrëzimin e regjimit komunist, kryesisht me anë të forcës së armëve. Për më shumë se një dekadë, një numër i madh i këtyre shoqatave u subvencionuan nga qeveria italiane, deri në çastin kur mbizotëroi pa kthim vendimi për të mos pranuar më kërkesa të kësaj natyre, por, përkundrazi, për të ruajtur e madje për të përforcuar regjimin e Enver Hoxhës si një faktor stabiliteti në rajon.

Në fund të kësaj hyrjeje të shkurtër, dëshiroj të nënvizoj përsëri se kërkimi shkencor, që ka prodhuar rezultatet e përmbledhura

në këtë vëllim, ka qenë i dobishëm për ta pastruar edhe më tej horizontin e marrëdhënieve italo-shqiptare të sotme prej paragjykimeve, dyshimeve apo interpretimeve të dykuptimta. Nuk ka më pikë dyshimi se elemente të tilla e dëmtojnë kuptueshmërinë e saktë të ngjarjeve të ndodhura dhe, në fund, pengojnë për të kuptuar kompleksitetin e marrëdhënieve ekzistuese në një histori të gjatë e të përbashkët fqinjësie. Punimet e paraqitura në këtë libër - si edhe punimet e vëllimit të mëparshëm - kanë synimin për t'u dhënë në dorë studiuesve të fushës dhe lexuesve të përbashkët një perspektivë më të qartë të marrëdhënieve të zhvilluara mes Italisë dhe Shqipërisë. Ndërkohë, pikërisht ekzistenca e pamohueshme e marrëdhënieve të tilla, me gjithë lëkundjet sipas periudhave historike, pohon se, në rast nevojë, ato i kanë dhënë formë një *unicum*-i marrëdhëniesh mes dy vendeve, që rrallëherë mund të vërehet në realitete të tjera në shkallë botërore.

Paolo Rago

VITET E ULJES SË TENSIONIT
Marrëdhëniet italo-shqiptare
në fazën kulmore të Luftës së Ftohtë

Settimio Stallone

Një shpresë e papritur

*Pesëmbëdhjetë vjet marrëdhënie
politike dhe ekonomike italiano-shqiptare (1961-1976)*

*Ëndrra e shuar: veprimet italiane drejt Shqipërisë
pas prishjes me BRSS-në.*

Konflikti politik dhe ideologjik midis Moskës dhe Tiranës, i shfaqur haptazi në mes të Konferencës së Moskës së 81 partive komuniste të nëntorit 1960, shpërtheu me ndëshkimin e dogmatizmit shqiptar në Kongresin XXII të PKBS-së, e që i mbylli punimet në tetor të vitit 1961, pra viktimë e javëve të fundit të atij viti të një *escalation*-i ku tashmë polemikat dhe akuzat ua lanë vendin fantazive personale - që në fillim u duk se nuk do të ishte as i shëndetshëm e as i gatshëm për kompromis¹. Ky zhvillim i situatës, tejet i papritur për diplomacitë e bllokut euroatlantik, por jo për atë italian, solli si pasojë një reflektim të përgjithshëm mbi politikën që duhej të ndiqte politika e Perëndimit ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë.

¹ Prishja midis Enver Hoxhës dhe Nikita Hrushovit u zyrtarizua më 10 dhjetor 1961 me urdhëresën e zëvendësministrit të Jashtëm Sovjetik, Nikolai Firjubin, dërguar personelit diplomatik dhe tregtar shqiptar për t'u larguar nga territori i BRSS-së. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 121, t. ris. nr. 4743/2125, Moskë, 13 dhjetor 1961. Sovjetikët, pavarësisht nga shtatëmbëdhjetë vjetët e një aleance jozyrtare, nuk kishin mundur ende të kuptonin së pari tiparet kombëtare të nacionalizmit shqiptar, ndaj të cilit zbatonin kategori interpretimi të përshtatshme për satelitët, duke e kufizuar kontrastin thjesht në një mosmarrëveshje ideologjike, bazuar në refuzimin e koncepteve dhe të politikave (braktisja e doktrinës së pashmangshmërisë së konfliktit dhe përshtatjes për rrjedhë të politikës së bashkekzistencës paqësore; zbatimin e marrëveshjeve të çarmatimit; marrjen e pushtetit me rrugë demokratike nga ana e lëvizjeve marksiste në shtetet kapitaliste; një vlerësim të ndryshëm të politikave të ndihmës ndaj vendeve në zhvillim), sigurisht të pranishme, por, në të vërtetë, në funksion të regjimit më shumë për dinamikën e tij të brendshme sesa për përcaktimin e një pozicionimi të ri të tij në fushën e shahut ndërkombëtar. Po aty, b. 13, t. nr. 4769/2164, Moskë, 20 dhjetor 1961.

Mbi të gjitha duhej të peshohej se deri ku do të shtyhej Kina në mbështetjen e saj ndaj regjimit. Ndonëse i matur, qëndrimi i Pekinit prej atyre ditëve nuk u shfaq i paqartë apo i pasigurt: Republika Popullore e Kinës dukej se synonte respektimin e atyre marrëveshjeve që shoqëronin solidaritetin politik me një ndihmë ekonomike të qenësishme². Për Shqipërinë kjo ishte një mundësi për të siguruar qëndrueshmëri sa më gjatë, e vendosur siç ishte për të ruajtur izolimin gjeografik, ku mbështetja kineze nuk do ta pengonte ecurinë e kujdesshme të përmirësimit të marrëdhënieve ekonomike e kulturore me sektorët më të afërt të Perëndimit. Në pritje për të vlerësuar nëse kishte ardhur momenti për të rihapur disa prej nismave të synuara për të mbështetur një çarmatim të pjesshëm në rajonin ballkanik³, RPSH-ja do të merrte rolin e elementit turbullues në kampin komunist, pasojë e një veprimi - atij sovjetik ndaj regjimit të Hoxhës - i cili, që në fillim kishte qenë “fragmentar, i rastësishëm, kontradiktor në disa drejtime”, viktimë e një konflikti të pazgjidhur mes dy politikave, asaj së jashtme dhe asaj doktrinare brenda partisë⁴.

Kjo situatë e re e detyroi qeverinë italiane të rishqyronte qëndrimin e saj diplomatik me Shqipërinë. Duke hedhur tej disa kushtëzime ideologjike - të cilave shpesh u ishte nënshtruar - ky qëndrim tani mund të ishte më konkret dhe t'i përshtatej një konteksti në të cilin RPSH-ja, më në fund, mund të gëzonte një autonomi vendimmarrëse, e papërfytyrueshme deri disa muaj

² Marrëveshjet kino-shqiptare u përpiluan në dy faza: më 2 shkurt dhe më 25 prill 1961 dhe u shprehën në një traktat tejet serioz, të cilit i bashkëngjitej një program ndihme teknike në fushën e bujqësisë, por veçanërisht në atë industriale, si edhe një dhënie kredie prej 125 milionë dollarësh. Po aty, b. 14, tel. nr. 9, Tiranë, shkurt 1961; tel. nr. 43, Tiranë, 25 prill 1961.

³ Ashtu si Plani Stoik i vitit 1957, me të cilin rumunët u kishin propozuar jugosllavëve, shqiptarëve, bullgarëve dhe turqve firmosjen e një pakti mossulmimi, bazuar në mospajjsjen me armë bërthamore të gadishullit - temë e rimarrë në deklaraten e përbashkët sovjeto-shqiptare të vitit 1959 dhe e shpallur në fund të vizitës së Hrushovit në Shqipëri apo propozimi bullgar i vitit 1959 për çarmatimin rajonal konvencional: projekte, megjithëse të mbështetura nga një pjesë e diplomacisë perëndimore me idenë se kështu do bësohej kompaktësia e bllokut sovjetik, ndaj të cilëve shqiptarët nuk ishin shprehur të gatshëm. Po aty, b. 121, t. ris. nr. 107/66, Paris, 17 shkurt 1962.

⁴ Shih analizën e hollësishme të ambasadorit italian në Moskë, Carlo Alberto Straneo, po aty, b. 121, t. ris. nr. 1231/600, Moskë, 12 prill 1962.

më parë, e vetmja vlerë e shtuar në një situatë që vëzhguesve ndërkombëtarë u dukej “e palogjikshme”, tek kërkonte, doemos, ndeshjen me një vend jashtëzakonisht më të fuqishëm, duke paguar çmimin e zvogëlimit tej mase të rëndësisë së saj strategjike⁵. Megjithëse kushtet gjeopolitike kishin ndryshuar, pa dyshim nuk vihej në diskutim “pika e vdekur” e politikës shqiptare nga ana e Italisë, ose ndryshe mbrojtja e pavarësisë dhe e integritetit territorial të shtetit fqinj përtej Adriatikut. “Superkomunizmi shqiptar” - siç edhe dogmatizmi i Hoxhës, nisi të përcaktohej në ato vite - ishte më i rrezikshëm për bllokun sovjetik sesa për aleancën perëndimore, arsye kjo përse në Romë shpresohej që partnerët euroatlantikë do ta kuptonin se këtu nuk ishte rasti për ta luftuar, edhe sepse ai, për një prirje të natyrshme, do të afrohej më me lehtësi vetëm me Italinë. Pra, nuk kishte vend për “një politikë aventurore”: ndërhyrjet e drejtpërdrejta apo jo të drejtpërdrejta - përfshirë edhe përmbysjen e një regjimi, i cili po i radikalizonte gjithnjë e më shumë qëndrimet e tij drejt një ekstremizmi të veçantë në kontekstin europian - do të minonin stabilitetin e një zone njaft të brishtë, e cila nuk do t'i përballonte dot kundërgoditjet⁶.

Rrjedhimisht, ishte e qartë se duke përqaftuar “politikën e veprimit”, jo pa rreziqe, Roma nuk mund t'ia lejonte më vetes papërgjegjshmërinë dhe të mos i kushtonte vëmendje Shqipërisë si dhe kërkesave të saj. Ashtu siç i rekomandonte edhe ministri i Punëve të Jashtme, Antonio Segni, përfaqësuesit të ri italian në Tiranë, Tristano Gabrici-t, me kujdesin e duhur dhe pa ngjallur shqetësime mes aleatëve - arsye për të shmangur “nisma të

⁵ Mbi parimet frymëzuese të politikës së jashtme shqiptare të atyre viteve dhe mbi ndikimin e tyre në marrëdhëniet me Italinë, shih studimin e Sokol Dedjes, *Le relazioni italiano-albanesi dopo il distacco dell'Albania dal campo socialista (1961-1965)*, tek *Una pace necessaria. I rapporti italiano-albanesi nella prima fase della Guerra fredda*, nën kujdesin e Paolo Rago-s, Laterza, Bari-Roma, 2017, f. 111-126.

⁶ ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 120, letër personale e Gabrici-t drejtuar Fornari-t, Tiranë, 2 shkurt 1962.

bujshme” ose “propozime tepër nismëtare” - duhej shtyrë përpara objektivi, përmes zhvillimit të një bashkëpunimi para së gjithash në fushën teknike, forcimi i lidhjeve (të cilat shumëkujt do t’i tingëllonin të diskutueshme moralisht) me një regjim vërtet të përçmuar, por drejtuesve të të cilit mund t’u rrënjosej ndjesia se me Perëndimin nuk mund të kishin më tepër kontakte se kaq, megjithëse vetë ata përjashtonin çfarëdolloj mundësie afrimi⁷. Në çdo rast, të paktën për atë moment, përgjegjësi i politikës së jashtme kombëtare e gjykoi të parakohshme të ndërmerreshin veprime hapjeje, që mund të përfundonin në të kundërtën e tyre, duke rrezikuar komprometimin e mëtejshëm të shqiptarëve ndaj sovjetikëve apo mund të ngjallnin dyshime te mbështetësit e tyre të rinj, kinezët⁸. Nuk duhej bërë as gabimi tjetër për t’u shfaqur si “mbrojtës”, sepse do të krijoheshin paralele me periudhën e fashizmit, kur, me gjithë rolin e rëndësishëm në zhvillimin e Shqipërisë, Italia ndoqi pa diskutim një politikë imperialiste⁹. Për sa i përket aleatëve - sipas Segni-t - duhej që ata të përgatiteshin, duke dhënë prova njohjeje të thellë të situatës shqiptare, e cila vazhdonte të mbetej e errët: Italia “vepronte në Shqipëri dhe për Shqipërinë” edhe në favor të tyre, e sigurt jo vetëm nga afërsia gjeografike, por edhe nga një përgatitje e arritur falë përvojës së saj historike me çështjet e këtij vendi¹⁰.

⁷ AMPJ, v. 1961. d. 486.

⁸ Tristano Gabrici, pasi u prit shkurtimisht nga ministri i Jashtëm, Behar Shtylla (që theksoi se marrëdhëniet midis dy vendeve mbeteshin “të përzemërta” duke u fortësuar në rrafshin ekonomik), i paraqiti përsëri letrat kredenciale presidentit të Presidiumit të Asamblesë Popullore, Haxhi Lleshi, më 9 dhjetor të vitit 1961: ceremonia u zhvillua në një atmosferë “të hapur dhe miqësore” (hollësi jo e parëndësishme, duke marrë parasysh ashpërsinë e njohur ceremoniale të regjimit). ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 12. Rap. nr 1365, Tiranë, 11 dhjetor 1961.

⁹ Kështu u interpretuan nga shqiptarët nismat e para italiane në gjirin e komunitetit ndërkombëtar. AMPJ, v. 1962, d. 652.

¹⁰ Dispozitat e dërguara nga Ministria e Punëve të Jashtme përfaqësive në vendet aleate, RPSJ-së dhe BRSS-së, merrnin shkas nga një sintezë e përgatitur që prej disa javëve, fillimisht nga DGPAP. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 11, *Komunikatë mbi Shqipërinë*, Romë, 11 dhjetor 1961. Për instruksionet: po aty, b. 22, tel. sekr. nr. 27235, Romë, 24 dhjetor 1961.

Një numër konsultimesh të ndërmarra nga *Farnesina*, nga fundi i vitit 1961 dhe fillimi i vitit 1962, solli rezultate veçanërisht pozitive¹¹. Kontaktet me amerikanët, më parë jozyrtare¹², që i ishin besuar ambasadorit Sergio Fenoaltea në Uashington¹³, nuk i zhgënjyen aspak parashikimet: megjithatë nuk ishte e lehtë që diplomacia amerikane të kuptonte se prishja mes Hoxhës dhe Hrushovit nuk duhej interpretuar si shenjë e vullnetit të Shqipërisë për të kaluar në kampin perëndimor¹⁴. Njëfarë interesimi për propozimet italiane u shfaq madje dhe nga *Foreign Office*-i, megjithëse Josef Godber-it, që në ato vite drejtonte diplomacinë britanike, ideja se kinezët mund të ishin një lloj ure në Mesdhe iu duk “e rëndë, shqetësuese dhe e rrezikshme”¹⁵. Për sa i përket qeverisë franceze, ajo e këshilloi ambasadorin Manlio Brosio të rekomandonte në Romë, sipas këtyre rrethanave, një “kujdes të

¹¹ Konsultimet, me kërkesë të Segni-t, më tej u shtrinë praktikisht në të gjitha përfaqësitë jashtë shtetit, të cilave iu kërkuar të përhapnin një “pikëpamje italiane mbi Shqipërinë”; në fakt ishte një deklaratë e artikullar në tri pika: marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe Greqinë; abstenim nga ndërhyrje të drejtpërdrejta dhe/ose jo të drejtpërdrejta; mbrojtje e pavarësisë dhe integritetit territorial shqiptar. Po aty, b. 120, t. sekr. nr. 18/1/0, Romë.

¹² Më shumë sesa prishje, amerikanët - duke filluar nga George Kennan, prej disa muajsh ambasador në Beograd - ishin habitur nga gatishmëria e sovjetikëve për të braktisur bazën e Sazanit (tetë nga dymbëdhjetë nëndetëset e zhvendosura ishin nisur prej andej që më 20 maj), nga ku, me gjithë ndryshimet rrënjësore të ndërfutura në vitet e fundit në kontekstin strategjik të Mesdheut, Marina e Moskës mund të kërcënonte nga afër vendndodhjet e NATO-s në zonën e Adriatikut dhe të Jonit. Po aty, b. 13, t. ris. nr. 634, Beograd, 12 dhjetor 1961.

¹³ Po aty, b. 120, tel. sekr. nr. 7, Uashington, 3 janar 1962.

¹⁴ Ishin këto - si vërente prerë drejtori i përgjithshëm i Çështjeve Politike të MAE-s, Giovanni Fornari - shtrembërimet tipike të “mentalitetit amerikan”, që shtynë Departamentin e Shtetit të mendonte gabim se, nëse shqiptarët ishin treguar të aftë të shkëputeshin nga Moska, do ta kishin edhe më të lehtë të largoheshin në të ardhmen nga Pekini vetëm “sepse (ky) ishte më i largët”. Po aty, b. 120, 1, sekr. nr. 12/2071, Romë.

¹⁵ NA, FO 371/165804, app, sekr., *Policy of Italian Gvmt towards Albania*, Londër, 4 janar 1962. Vëzhgime që nuk e shqetësuan Pietro Quaroni-n më shumë se ato të vetë Godber-it mbi një opinion të tijin për sigurinë e Adriatikut, për komunizmin titist ndaj atij shqiptar, sa të shtynte ambasadorin italian të paralajmëronte *Farnesina*-n se, nëse “diçka” do të ndodhte për të afruar Tiranën me Beogradin kjo gjë “nuk do të shihej me sy të keq” në Londër, së cilës, në këtë rast, nuk i duhej zënë besë. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 120, t. sekr. nr. 01, Londër, 5 janar 1962.

jashtëzakonshëm”, megjithëse ngulmonte se ajo që po ndodhte në Shqipëri ishte diçka e dobishme dhe patjetër do të sillte mundësinë e perspektivave më të gjera të depërtimit perëndimor¹⁶. Më në fund, për turqit - që me kohë kishin arritur, falë lidhjeve historike me një pjesë të shoqërisë shqiptare, aftësi të lëvdueshme dhe të pakrahasueshme interpretimi të dinamikave komplekse të atij vendi - Italia duhej të kishte një “rol të dorës së parë” në përpjekjen për të nxitur një “kapje” të Shqipërisë nga Perëndimi: madje - siç i sugjeruan ambasadorit në Ankara, Mario Lucioli-t, si ministri i Punëve të Jashtme, Selim Sarper, edhe sekretari i përgjithshëm i atij dikasteri, Namik Qemal Jolga - ishte rasti “për të bërë diçka më shumë” për të përforcuar ndarjen shqiptare¹⁷. Mbeteshin për t’u parë synimet e Greqisë dhe të Jugosllavisë, dy fuqitë e vetme të cilat, nga pozicioni gjeografik dhe rutina historike, mund ta minonin rolin që Italia synonte të luante ndaj “Shqipërisë së Re”.

Grekët u hodhën menjëherë të përgënjeshtrojnë zërat, të përhapur kryesisht nga shtypi jugosllav, se ata kishin ndërhyrë së fundmi në territorin shqiptar: Segni-t, që e kishte takuar pikërisht në ditët e turbullta të dhjetorit të vitit 1961, ministri grek i Punëve të Jashtme, Evangelos Averoff, iu duk i sinqertë, edhe pse *Farnesina*-s nuk iu duk e tepërt të hidhej një hop në Athinë për të theksuar se “asnjëri prej tre fqinjëve (nuk duhej) t’i hynte aventurave”¹⁸.

Me gjithë konfirmimin e një qëndrimi jondërhyrës, në bisedimet që ambasadori italian në kryeqytetin helen, Mario

¹⁶ Po aty, b. 22, t. nr. 17732/4016, Paris, 6 dhjetor 1961. Të njëjtat koncepte u përsëritën në Paris ndaj këshilltarit asokohe të ri në moshë Francesco Malfatti-t. Po aty, b. 120, tel. sekr. nr. 2069, Paris, 30 dhjetor 1961. Edhe qeveria e Gjermanisë Federale shprehu përbashkësi opinionesh me qëndrimet italiane. Po aty, b. 12, t. nr. 063, Bonn, 29 dhjetor 1961.

¹⁷ Edhe pse kjo gjë, gjithnjë sipas drejtuesve të politikës së jashtme turke, nuk do të kishte ndryshuar në thelb ekuilibrat e rajonit. Po aty, b. 120, t. nr. 429/256, Ankara, 27 shkurt 1962; t. sekr. nr. 454/272, Ankara, 3 mars 1962.

¹⁸ Segni, me qëllim përforcimi, vendosi të ndërfaqste në një diskutim të përgjithshëm, mbi politikën e jashtme kombëtare, parashikuar shumë shpejt në parlament, një thirrje tashmë të modelit të vjetër, por gjithnjë si deklaratë e vlefshme mbi pavarësinë e Shqipërisë të Carlo Sforza-s - ndonëse e frymëzuar nga sekretari i përgjithshëm i atëhershëm i MAE-s, Vittori Zoppi - në gusht të vitit 1949. Po aty, b. 120, app. sekr. e DGAP-it, *Colloquio con Averoff*, Romë, 20 dhjetor 1961.

Conti, pati me drejtorin e përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Christos Ksanthopoulos-Palamas, grekët shfaqën dyshime ndaj një regjimi që e quanin të papërputhshëm me vlerat e komunitetit euroatlantik. Ishte e qartë se, pavarësisht që nuk e përmendte më aneksimin e Epirit të Veriut, qeveria e Athinës, druhej tek shihte aleatët t'i kërkonin të normalizonte marrëdhëniet me RPSH-në, gjë tejet acaruese për të, të paktën mbetej më pak kundërshtuese ndaj përmirësimit të marrëdhënieve me Tiranën¹⁹. Greqia e kuptonte nevojën e një “politike shqiptare”, por, në të njëjtën kohë ngulmonte se, në qoftë se në NATO ishte vendosur që në njëfarë mënyre ta afronin regjimin e Hoxhës, kjo u duhej ngarkuar francezëve: ide tepër absurde, aq sa dukej se nxirrej si pretekst dhe dëshmonte se çdo nismë e Italisë për Shqipërinë do të shkaktonte pothuajse gjithmonë ndikime negative midis Romës dhe Athinës, ku - pjesërisht edhe për arsye të politikës së brendshme - vazhdohej të këmbëngulej se politika italiane për Adriatikun nuk ishte imunizuar ende nga prirjet imperialiste²⁰.

Por, nëse qëndrimi grek, megjithëse mjaft i diskutueshëm, ishte tepër i qartë për *Farnesina*-n, shumë më e vështirë ishte të kuptohej se cili qëndrim i jugosllavëve mund të quhej më i efektshëm ndaj këtij bashkërendimi ndërkombëtar në lidhje me Shqipërinë²¹. Marrëdhëniet midis dy vendeve vazhdonin të

¹⁹ NA, Fo 371/165803, t. sekr. nr. 1032/2/62, Athinë, 3 janar 1962. Në këtë fazë të ndryshuar historike mbajtja e rivendikacioneve për Shqipërinë e Jugut ishte tashmë për Athinën një mjet taktik për të përfitur në ndonjë marrëveshje me regjimin shqiptar në shkëmbim të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike, garantimin për minoritetin grek për njohjen e një sërë të drejtave: diplomacia greke prej kohe po “tossing around” ide të tilla për të testuar reagimet e partnerëve aleatë. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 118, t. ris. nr. 012, Uashington, 23 janar 1962.

²⁰ Ngjall kureshtje jo të paktë që një sugjerim i tillë të vinte nga grekët; sipas tyre, te *leadershipi* shqiptar ekzistonte një lloj “ndikimi kulturor” francez, i cili me sa dukej e mbivlerësonte frekuentimin e një kohe të kaluar, shumë të largët të një pjese të drejtuesve të regjimit të Liceut francez të Korçës. Po aty, b. 12, tel. sekr. nr. 249, Athinë, 30 dhjetor 1961; b. 120, rap. nr. 4/1, Athinë, 3 janar 1962.

²¹ Ambasada italiane në Uashington, as nga kontaktet që kishte me funksionarë të lartë të CIA-s nuk kishte mundur të merrte ndonjë sinjal mbi synimet e Beogradit ndaj Tiranës, ndonëse shërbimet amerikane ishin të sigurta se afrimi mes PKBS-së dhe PKJ-së do ta ringjallnin dëshirën e Titos për ta federuar njëfarësoj Shqipërinë në RSFJ. Po aty, b. 120, app. sekr., *Colloquio con vice direttore della CIA*, Uashington, 4 janar 1962.

ftohta, sipas Beogradit për shkak të armiqësisë së palëkundshme dhe të paarsyeshme të Enver Hoxhës ndaj RSFJ-së. Në rajonin e Adriatikut me shumë mundim ishte arritur një ekuilibër, të cilin jugosllavët nuk kishin për qëllim ta cenonin²². Duke përfituar kështu nga situata e dobët në të cilën ndodhej RPSH-ja, e që do të dëmtonte marrëdhëniet - tashmë të mira - me Italinë, e cila kishte çdo të drejtë të zhvillonte një politikë të sajën me Shqipërinë: në këtë pikë në Beograd nuk kishte dyshime, megjithëse regjimi do të përpiqej t'i shfrytëzonte këto "presione të jashtme" për t'u konsoliduar, duke përdorur komponentin nationalist që Hoxha e kishte integruar në komunizmin shqiptar²³. Për më tepër jugosllavët ishin skeptikë rreth mundësisë që Shqipëria mund të shfrytëzohej nga komuniteti euroatlantik për të ushqyer mosmarrëveshje kino-sovjetike, sepse blloku socialist, në të gjitha shpërfaqjet e tij, prirej t'i kufizonte - me anë të mekanizmit mbrojtës endogjen - tensionet që mund ta bënin të përshtueshëm nga ndikimet përëndimore²⁴.

Në këto rrethana, perspektiva e konsultimeve të herëpashershme me grekët dhe jugosllavët mbi çështjen shqiptare mund t'i zbuste shqetësimet e pritshme dhe të pajustificuara të këtyre dy qeverive, duke filluar që nga hiperndjeshmëria greke, burim i vazhdueshëm propozimesh që mund të zbërtheheshin si "wishful thinking"²⁵, duke penguar kështu *Farnesina-n* të binte

²² Ministri i Jashtëm jugosllav, Koča Popović në bisedë me Kennan-in, i përjashtoi si "fantazi" deklaratat e shtypit që e shihnin Beogradin të gatshëm të pushtonte Shqipërinë me mbështetjen e sovjetikëve. FRUS, 1961-1963, vol. XVI, dok. nr. 115.

²³ Në atë Ministri të Jashtëm qëndrimi italian mbi çështjen shqiptare vlerësohej në tërësinë e tij. Megjithatë, situata ishte "delikate", motiv për të cilin - si sugjeroi drejtori i departamentit politik, Salko Fejce - ishte ndoshta e dëshirueshme një politikë "hands off" nga të gjitha palët. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 12, tel. sekr. nr. 547, Beograd, 29 dhjetor 1961.

²⁴ Shih, mbi këtë çështje, bisedimet mes Straneo-s dhe homologut të tij jugosllav, Cvijetin Mijatović. Po aty, b. 120, tel. sekr. nr. 59, Moskë, 21 janar 1962.

²⁵ Njësoj si ideja ekstravagante - e hedhur për herë të parë në Departamentin e Shtetit që të nesërmen e prishjes së Hrushovit dhe Hoxhës - për të mbështetur daljen e Shqipërisë nga kampi socialist përmes një programi ndihme financiare dhe materiale (në Itali u vu në lëvizje Fondacioni *Cini*) që regjimi nuk do ta pranonte kurrë. Po aty, b. 121, t. 121, t. ris. nr. 812/352, Uashington, 2 shkurt 1962.

në një mendje me ta për një aksion të përbashkët, që vlerësime të tjera e të ngjashme, por, në të vërtetë, për shkak të prirjeve të ndryshme, do ta pengonin të dilte me sukses²⁶. Për sa i përket aleatëve, Roma - me synimin për të arritur shpresën e saj si një urë lidhëse midis Perëndimit dhe RPSH-së²⁷ - gjykoj se Këshilli Atlantik ishte institucioni më i përshtatshëm për të komunikuar këndeje e tutje iniciativat e saj për Shqipërinë. Ndonëse me pak dallime nga ana e gjermano-perëndimorëve, britanikëve (të dyja palët për arsye të ndryshme ishin pak të gatshme të bashkëpunonin me regjimin) dhe të turqve (të cilët, përkundrazi, mbështesnin një politikë “realiste dhe aktive”, që donin ta shndërronin çështjen shqiptare në një *test case*, përmes të cilit t’u tregonin satelitëve se edhe mund t’i bëhej ballë presionit sovjetik²⁸), përfaqësuesit

²⁶ Ende në nëntor të 1962-shit - me rastin e vizitës së presidentit të Republikës Segni në Athinë - ministri i sapoemëruar i Punëve të Jashtme, Attilio Piccioni, u detyrua të kundërshtonte kryeministrin grek Kostasinos Karamanlis dhe homologun e tij, Averoff-in, duke i thënë se Italia nuk do të ndërmerre asnjë iniciativë politike apo ushtarake ndaj Shqipërisë. Po aty, b. 120, app., *Visita in Grecia del presidente della Repubblica*, Romë, 30 tetor 1962.

²⁷ Përpjekja e përpunuar në pranverën e vitit 1962 nga *Farnesina*, me autorizimin e Departamentit të Shtetit, për të mbështetur kontaktet, qoftë edhe jozyrtare, mes anëtarëve të përfaqësive amerikane e shqiptare në Romë ushquu shpresat se Italia mund të mbështeste edhe një afrim të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara, ku, në rast se RPSH-ja do ta merrte në konsideratë propozimin për të vendosur marrëdhënie diplomatike, çështja do të këqyrej me kujdes. Gjithsesi, sondazhet e ushtruara mbi diplomatët shqiptarë nuk gjetën përgjigje pozitive te drejtuesit e regjimit. Po aty, app. Della DGAP, Romë, 16 maj 1962; b. 120, ris., *Incontro con il consigliere Vangjeli*, Romë, 21 maj 1962.

²⁸ Pozicioni turk - i kundërt me qëndrimin “tepër të kujdesshëm dhe të përbajtur” të shumicës - bazohej edhe mbi sondazhet jozyrtare që, në fund të dimrit të vitit 1962, ambasadori shqiptar në Ankara, Skënder Konica, kishte kryer për t’u siguruar nëse perëndimorët do të ishin të gatshëm të pranonin që një afrim i mundshëm i RPSH-së me bllokun euroatlantik mund të realizohej pa një ndryshim në udhëheqjen e regjimit. Edhe pse Yolga ia mohoi Luciollit-ekzistencën e të tilla *avances*, duke saktësuar se me shqiptarët nuk ishin përballur asnjëherë biseda mbi të tilla tema, diplomacia italiane - që ishte njoftuar nga burime të sigurta, me shumë gjasë të afërta me mërgatat politike shqiptare - theksoi se turqit dhe shqiptarët ishin shtyrë “edhe më tej”: provë e qartë ishte zhgënjimi me të cilin qeveria e Ankarasë e priti vendimin amerikan për të mos mbështetur idenë e një politike dinamike ndaj Shqipërisë. Po aty, b. 121, t. ris. nr. 1596/747, Paris, 20 mars 1962. Mbi sondazhet e Konicës: po aty, DGAP 1963, b. 21, t. nr. 12/486, Romë, 3 prill 1963; sekr. nr. 973/541, Ankara, 15 maj 1963. Edhe ministri i Jashtëm austriak, Bruno Kreisky, në dy bisedime me John. F. Kennedy-n, u ankuar për apatinë e Perëndimit mbi çështjen shqiptare, sipas tij simptomë e dobësisë së *leadershipit* sovjetik dhe që duhet të ishte shfrytëzuar. FRUS, 1961-1963, vëll. XVI, dok. nr. 181 dhe nr. 185.

e vendeve të NATO-s pranuan të udhëhiqeshin, gjë që e lehtësoi Romën nga rekomandimet e Departamentit të Shtetit²⁹. Të tjera nisma - si ato që diplomacia italiane zhvilloi në Këshillin e Europës, ku parlamentari demokristian, Lodovico Montini, i propozoi Këshillit të ministrave linja veprimi mbi një të ardhme të mundshme të Shqipërisë - dëshmuuan se roli i Italisë, si referente e parë e komunitetit ndërkombëtar, mbi problematikat shqiptare ishte i padiskutueshëm³⁰.

Ndërkohë, siç ishte parashikuar, nga Tirana po mbërrinin me njëfarë rregullsie disa ftesa për t'i kaluar në një nivel më të lartë marrëdhëniet në fushën teknike. Nëse kërkesa për të krijuar kushtet për të përcaktuar paraprakisht një marrëveshje në veterinar u pasua me një bashkëpunim veçanërisht të frytshëm³¹, aktivizimi i marrëveshjeve tregtare trevjeçare të nënshkruara në Romë më 6 dhjetor 1961, do të ishte një mundësi e duhur për t'i dhënë rast regjimit qoftë për të kompensuar me mallra italiane pagatishmërinë e parashikuar, që ishte ndier nga zona e Comecon-it,

²⁹ Në gjirin e Committee of Political Advisers-it u vendos të paktën për momentin, me sugjerimin e Uashingtonit (që për Hoxhën - i shkroi disa herë Romës përfaqësuesi italian Adolfo Alessandrini - kishte ndjekur një politikë realiste) për të mos penguar përforcimin e marrëdhënieve mes Tiranës dhe Pekinit. Duheshin shmangur ato nisma për Shqipërinë, as në favor, as kundër Pekinit dhe që mund të interpretoheshin si një ndërhyrje në konfliktin sovjet-shqiptar; nga ana tjetër kjo nuk e përjashtonte mundësinë e një përforcimi të marrëdhënieve diplomatike dhe tregtare mes RPSH-së dhe vendeve të NATO-s, por pa bërë publicitet. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 121, conf. nr. AC/119-WP (62) 12, Paris, 26 shkurt 1962; t. ris. nr. 1469/688, Paris, 14 mars 1962.

³⁰ AMPJ, v. 1962, d. 652.

³¹ Ky bashkëpunim e pati zanafillën me ardhjen në Shqipëri (31 tetor-7 nëntor 1961) të doktor Giuseppe Boldrin-it nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Veterinare të Ministrisë së Shëndetësisë, që u prit me përzemësi nga autoritetet e vendit, të cilat bujarisht i vunë në dispozicion të gjitha elementet e nevojshme për të vendosur marrëdhënie mes dy vendeve në këtë fushë, pa i fshehur kushtet e prapambetura lokale. Ky mision pozitiv hodhi bazat për studimin e një marrëveshjeje, që, ndonëse e bazuar mbi premisën e reciprocitetit, do të sillte transferimin e kompetencave "jo proporcionalisht në favor të Shqipërisë": do të ishte një rast, pa rëndesa të veçanta financiare, si për të dhënë një sinjal të qartë gatishmërie nga ana e regjimit si dhe për të ndërtuar një operacion riafrimi ndaj atij brezi specialistësh shqiptarë të cilët, të formuar gjatë periudhës së luftës, shprehnin ende një ndjeshmëri pozitive e të natyrshme ndaj Italisë. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 12, app. nr. 12/2019, Romë, 14 dhjetor 1961.

qoftë për t'i hapur rrugë të reja tregu produkteve shqiptare³². Kjo ndodhte edhe për shkak të nevojës, tepër të ndjeshme në Tiranë, për të baraspeshuar më mirë shkëmbimet mes dy vendeve, historikisht të karakterizuara nga një mosbarazi jo e vogël ndaj eksporteve italiane. Anomali, e cila - për arsye të gatishmërisë së shtuar të valutës, pasojë e ndihmës kineze ndaj RPSH-së - rrezikonte të mprihej më shumë nga mungesa e përhershme për faj të zhvillimit të prapambetur kronik të ekonomisë lokale, e mundësive konkrete për të rritur tipologjinë dhe sasinë e mallrave që duheshin blerë përtej Adriatikut³³. Mbështetja e Pekinit,

³² Me gjithë interesin e dukshëm të regjimit për të rritur ndjeshëm marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve, negociatat - të nisura që në verën e vitit 1960 dhe në fazë operative që nga korriku i vitit 1961 - u zhvilluan me ngadalësi të madhe, me sa dukej të kushtëzuara nga ndryshimet që po ndodhnin në direktivat e politikës shqiptare. Një mision i një delegacioni italian (i cili, i drejtuar nga ministri i Plotfuqishëm Pierluigi Alverà dhe i përbërë nga përfaqësues të gjashtë dikastereve - Punët e Jashtme, Thesari, Agrikultura, Industria, Marina Tregtare dhe Tregtia e Jashtme - si dhe nga Zyra Italiane Cambi, u organizua në mënyrë të qëllimshme, i ndërlikuar për të testuar ndjeshmërinë, ose së paku, një hapje ose jo më të madhe të Shqipërisë ndaj Italisë) u anulua me kërkesë të regjimit vetëm pak ditë përpara mbërritjes së tij, që do të ishte më 6 shtator. Në fillim të tetorit ambasada shqiptare në Itali kërkoi që bisedimet të zhvilloheshin në Romë, duke nxjerrë si shkak që shqiptarët do ta kishin më të lehtë të vendosnin marrëdhënie me shoqëritë italiane: në të vërtetë, regjimi, i përfshirë në prishjen me Moskën, parapëlqeu të mos binte shumë në sy për këto marrëveshje, por edhe për të përgënjeshtuar zërat, të përhapur enkas në Beograd, sipas të cilëve midis Romës dhe Tiranës po zhvillohej ideja e dhënies së kredive në një kuadër të gjerë të asistencës teknike. AMPJ, v. 1961, d. 486. Vetëm pas mbërritjes në Itali, më 12 nëntor, të delegacionit të drejtuar nga Theohar Fundo dhe nga Mihallaq Lako, u bë e mundur që traktativat të përshpejtoheshin. Marrëveshjet, që përfshinin periudhën midis 1 janarit 1962 dhe 31 dhjetorit 1964 (shqiptarët nuk pranuan që ato mund të rinovoheshin automatikisht në fund të mandatit, duke ngulmuar se duhej paraqitur çdo vit lista e mallrave merceologjike të pranuar, për arsye se në këtë mënyrë do të pranohej zyrtarisht klauzola e CEE-s), i rritën shkëmbimet në nivel tërësor midis dy vendeve deri në rreth 50%. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 12, t. nr. 47/ 18409, Romë, 9 shtator 1961; tel. nr. 104, Tiranë, 16 shtator 1961; tel. nr. 111, Tiranë, 11 tetor 1961; t. 47/21729, Romë, 10 nëntor 1061; app., *Sviluppo dei rapporti commerciali con l'Albania*, Romë, 10 nëntor 1961. Për tekstin e marrëveshjeve, shih po aty, b. 22.

³³ Njëkohësisht me marrëveshjen - që shoqërohej dhe me një shkëmbim notash rreth sistemit të pagesave, që do të shlyheshin në lireta apo edhe në lloje të tjera valutash, të konvertueshme në tregun kombëtar të divizave - u nënshkrua një protokoll për shkëmbimet tregtare për vitin 1962 që parashikonte një vëllim shkëmbimesh të barabartë me 2 miliardë e 600 milionë lireta në secilën nga të dyja drejtimet, megjithëse nga pala italiane gjykohej se vlera e eksporteve drejt Shqipërisë (kryesisht produkte kimike, farmaceutike, antiparazitarësh, mjete motorike, pjesë këmbimi dhe makineri për industrinë e bujqësinë) e kalonte pa dyshim bilancin prej të paktën gjysmë miliard litretash të importeve të parashikuara, lista e të cilave (përfshirë mbi të gjitha vajgurin e papërpunuar, bitumin, kromin, hekurin dhe lëndën e drurit) kishte vlerën e një parashikimi më tepër teorik. Po aty, bv. 22, t. ris. nr. 47/25208, Romë, 14 dhjetor 1961.

ndonëse e konsiderueshme, në të vërtetë, nuk zgjidhte dy probleme të rëndësishme për ekonominë shqiptare: furnizimin me makineri industriale dhe lidhjen me tregjet ndërkombëtare të prodhimeve minerare dhe ato bujqësore, që historikisht përbënin kuotën kryesore të shkëmbimeve me vendet e tjera³⁴, një arsye më tepër që regjimi të detyrohej menjëherë të vlerësonte me më shumë interes mundësinë e shtimit të shkëmbimeve me vendet fqinje³⁵.

Përsheptimi, nga ana e autoriteteve shqiptare, i sondazheve me shoqëri italiane për të ndërtuar një impiant për prodhimin e plehrave azotike³⁶ dhe vendimi i *Palazzo Chigi*-t për të bindur *Alitalia*-n të hapte një linjë ajrore (veçanërisht të kërkuar nga shqiptarët³⁷) Romë-Tiranë, *via Bari*³⁸ - megjithëse parashikohej edhe një humbje jo e vogël për kompaninë ajrore - ishin shenja që parashikonin se përforcimi i marrëdhënieve dypalëshe, i hamendësuar menjëherë pas prishjes mes Hoxhës dhe Hrushovit, kishte sjellë shumë shpejt rezultate konkrete, që duheshin të vendoseshin pa vonesë në një dimension më tepër teknik sesa

³⁴ Të gjitha marrëveshjet që rregullonin marrëdhëniet mes dy vendeve (një marrëveshje për lejimin e kredive së cilës i shtoheshin katër protokolle shtojcë - tregtar, merceologjik, ai i pagesave si dhe ai i bashkëpunimit teknik-shkencor) u rinovua në Pekin më 13 janar 1962, pra në më pak se një vit pas atyre të mëparshmeve. Edhe pse këto marrëveshje të reja kishin lejen të shtonin shkëmbimet tregtare deri në 23%, nga pala shqiptare mbetej njëfarë pakënaqësie për ritmin e ngadaltë të ecurisë së programit të ndihmës dhe për rezistencën nga ana e Pekinit, për të dërguar një numër të mjaftueshëm teknikësh që do të vinin në jetë planet e industrializimit të parashikuara prej regjimit. Po aty, b. 120. App., *Osservazioni sulla situazione albanese*, Tiranë, 5 shkurt 1962; b. 119, t. segr. nr. 1260/704, Tiranë, 20 tetor 1962.

³⁵ Në këtë drejtim duhet parë edhe përpjekja e tij për të hedhur në tregun italian sasi gjithnjë e më të mëdha naftë. Po aty, b. 11, t. ris. nr. 1321/876, Tiranë, 25 nëntor 1961.

³⁶ Në vijim të një iniciative të mëparshme të Società Nazionale Metanodotti (SNAM), në fund të nëntorit të vitit 1961, Edison-i paraqiti një projekt të parë për një fabrikë - kostoja e së cilës arrinte deri në 15 miliardë dollarë dhe për t'u ndërtuar nevojitej dërgimi në vend i 300 teknikëve italianë për një periudhë dyjavore - e që do të prodhonte 120 mijë ton nitrat amoni dhe 180 mijë ton amoniak në vit.

³⁷ AMPJ, v. 1962, d. 652.

³⁸ Doli nevoja - kusht i kërkuar nga Civilavia - të përshtatej infrastruktura e aeroportit të Tiranës: në këtë mënyrë u bë e mundur të realizohej fluturimi i parë më 15 prill 1962. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 120, fonogramma ris. nr. 13738/AC2, Romë, 7 mars 1962.

politik, për të bërë të mundur, gjithsesi, që në rrafshin ekonomik Italia të merrte një rol që nuk mund të zëvendësohej lehtësisht, në kontekstin e marrëdhënieve me Tiranën me pjesën tjetër të komunitetit ndërkombëtar³⁹.

Plotësimi i kërkesave shqiptare, edhe duke u shtrënguar për ndonjë lëshim - siç i rekomandoi sekretari i përgjithshëm i *Farnesina*-s, Attilio Cattani, përgjegjësit të drejtorisë për Shqipërinë të DGAP-it (Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Politike), Gian Vico Borromeo-s - do ta nxiste RPSH-në, të ndiqte një politikë të jashtme të aftë, të siguronte një pozicion ndërkombëtar më dinamik, që mund ta çlironte nga detyrimi për të zgjedhur mes Moskës dhe Pekinit, madje edhe t'i dorëzohej përthithjes jugosllave⁴⁰. Duhej shfrytëzuar ky moment, që ishte pa dyshim i favorshëm⁴¹, duke iu ofruar shqiptarëve disa koncesione, si “gjest i vullnetit të mirë”⁴². Në këtë drejtim Cattani iu shpreh hapur ambasadorit shqiptar në Romë, Jordan Panit: qeveria italiane mundej, në një kohë më të përshtatshme dhe me metoda, po ashtu më të përshtatshme, të kontribuonte në zhvillimin e Shqipërisë⁴³. Kjo do t'i bënte të mundur këtyre sektorëve të regjimit, që kishin një vizion realist të politikës së jashtme kombëtare, të nxisnin me kujdes një orientim drejt Italisë. Kështu jo vetëm Roma do të ishte

³⁹ Këto rezultate ngjallën shqetësim në Athinë, ku, për të zbutur shtypin qeveria vendosi të ftonte në Tiranë presidentin e Lëvizjes Greke për Mirëkuptimin Ballkanik, Stamatias Merkuris dhe të dërgonte në Greqi homologun e tij shqiptar, Qirjako Harito, i cili shoqëroi Javier Malon, anëtar i Komitetit Qendror i Frontit Demokratik: nisma thjesht simbolike, pa ndonjë pasojë të drejtpërdrejtë, por gjithsesi krijuan kontaktin e parë zyrtar mes dy vendeve që nga koha e Luftës së Dytë Botërore. Po aty, b. 120, t. sekr. nr. 781/412, Tiranë, 6 qershor 1962.

⁴⁰ Po aty, b. 119, app. pranë nr. 762/413, Romë, 9 qershor 1962; l. nr. 12/788, Romë, 6 korrik 1962.

⁴¹ Shumë shpejt - në dhjetor 1962 - do të përfundoheshin operacionet për nxjerrjen dhe riatdhësimin e eshtrave të ushtarëve të rënë italianë në dy luftërat botërore (rënë dakord në marrëveshjet e dhjetorit të vitit 1958 dhe të marsit 1959), një operacion i suksesshëm që e zbuti mjaft klimën mes dy vendeve. AMPJ, v. 1965, d. 504.

⁴² Si për shembull komunikim telefonik e telegrafik të drejtpërdrejtë apo marrëveshje teknike në fushën shëndetësore, botanike e në pronësinë intelektuale. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 122, n. nr. 1/1132, Romë, 27 tetor 1962; po aty, DGAP 1963, b. 21, app. nr. 42/05452, Romë, 14 mars 1963.

⁴³ AMPJ, v. 1963, d. B II/15.

më e fortë në sistemin adriatik, në një fazë kur sjellja e Beogradit dukej se po priste heshturazi si do të shkonin ngjarjet, por do të mundte edhe të mposhte qëndresën e asaj pjese të komunitetit euro-atlantik - megjithëse pozicionet italiane mbështeteshin gjithnjë nga amerikanët - e cila e akuzonte Italinë për gatishmëri të tepruar. Ekzistonte rreziku që *Farnesina*-s t'i kërkohej të rishikonte politikën e saj "pro Shqipërisë", e filluar që nga fundi i vitit 1961 dhe, pa qenë armiqësore të tregonte "një interesim më të paktë", duke pasur parasysh rezultatet pa ndonjë rëndësi të arritura deri tani⁴⁴. Duhej, pra, të tregohej durim i pakufishëm për të mos u mposhtur nga agresiviteti i pajustificuar i një regjimi që - duke nxjerrë si shkak çështje të dorës së dytë apo incidente krejt pa rëndësi, shpesh i shfrytëzonte për të mbuluar, me ndonjë shfaqje antiperëndimore, nismat e tij gjithnjë të kufizuara për t'u afruar me bllokun euroatlantik⁴⁵ - dukej sikur nuk dëshironte të merrte parasysh përpjekjen e diplomacisë italiane për ta integruar në komunitetin ndërkombëtar. Megjithatë, përtej vlerësimeve të karakterit politik në përgjithësi, nuk do të ishte moralisht e pranueshme që Shqipëria të braktisej në fatin e saj duke tradhtuar ndjenjën e miqësisë pozitive e të qëndrueshme mes dy popujve

⁴⁴ NA, FO 371/165802, *Prime Minister's visit to Washington brief nr. 2. Albania*, Londër, prill 1962. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 120, l. sekr. nr. 14/961, Romë, 22 dhjetor 1962.

⁴⁵ Sekuestrimi i motopeshkarexhave të akuzuara sikur kishin shkelur ujërat territoriale shqiptare, kufizimet e paprera për qarkullimin e personelit diplomatik, përpjekjet për t'iu shmangur rrugëve tregtare zyrtare, qëndrimet e ashpra - ndonëse në masë shumë më të paktë në krahasim me të kaluarën - ndaj atyre pak qytetarëve italianë të mbetur ende në Shqipëri dhe bashkëshorteve shqiptare të atyre që kishin mundur të riktheheshin në Itali, protesta e vazhdueshme për shkak të përmbajtjes së artikujve të gazetave apo emisioneve radiotelevizive për RPSH-në: një *cahier de doléances*, që nuk arrihej kurrë t'i jepej fund. Për më tepër, edhe në vitin 1962, personeli i legatës shqiptare në Romë - siç qe rasti i sekretarit të parë, Koço Kallço, i kapur në befasi teksa po merrte nga një oficer rezervë i ushtrisë italiane dokumente sekrete (ky incident u pasua me dëbimin e diplomatit shqiptar, që reciprokisht u pasua me dëbimin e sekretarit të parë të legatës italiane në Tiranë, Giovanni d'Aloja) - merrej me veprimtari spiunazhi, të cilat, pa ndonjë vlerë të vërtetë ushtarake, prodhonin të vetmin rezultat, ngadalësimin e zhvillimit pozitiv të marrëdhënieve dypalëshe dhe përforcimin tezën e atyre vendeve të NATO-s që e shihnin si të tepruar politikën italiane ndaj regjimit. Po aty, b. 118, tel. sekr. nr. 3, Romë, 13 janar 1962; tel. nr. 32, Tiranë, 13 shkurt 1962. Për versionin shqip të fakteve shih AMPJ, v. 1962, d. 652.

dhe që e bënte Italinë të shihej nga shqiptarët si një vend mik e i admiruar nga qytetërimi fqinj perëndimor. Një ndjenjë që regjimi nuk e anashkalonte dhe ndaj së cilës, duke theksuar menjëherë pas luftës dallimin mes qeverisë dhe popullit italian, nuk e kundërshtonte më, por që, njëkohësisht, mundej edhe ta dobësonte, sikur të mos ishte mbështetur - ky ishte opinionin e të gjithë diplomatëve në shërbim në Tiranë pas 1954-ës - përmes një përpjekjeje që prirej të ushqente, me mjetet e përshtatshme, një klimë marrëdhëniesh më të mira e kontaktesh më të shpeshta mes dy vendeve⁴⁶.

RPSH-ja po kalonte një periudhë delikate konjunktive politike, që po bëhej edhe më shumë problematike nga kushtet ekonomike në rang vendi e që, në ato vite të para të gjashtëdhjetës, ishin të tmerrshme. Edhe pse rezultatet e arritura në fushën e industrisë mund të përcaktoheshin si inkurajuese, ndërprerja e ndihmave sovjetike - të vulosura nga mospranimi i ftesës në sesionin XV-të COMECON-it, i parashikuar nga Moska të mbledhesh në qershor të vitit 1962⁴⁷ - ua kishte bërë të qartë shqiptarëve se përjashtimi progresiv nga blloku lindor do ta bënte të pamundur realizimin e planit të tretë pesëvjeçar⁴⁸. Në sektorin parësor, ku prodhimi nuk kishte qenë kurrë në gjendje t'i bënte ballë nevojave ushqimore të popullsisë së mësuar historikisht me mungesa, tre vjet me

⁴⁶ Një afrim me popullin dhe kulturën italiane, ajo që perceptohej nga shumica e shqiptarëve, që gjente konfirmim të saktë në deklaratat - e bëra shërbimeve sekrete amerikane - e informatorëve, të të arraturëve, të dezertorëve, emigrantëve që ia dilnin të vinin në Perëndim apo të komunikonin me të. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 119, dosja nr. A-252/254, Frankfurt, 3 gusht 1962; t. sekr. nr. 1113/610, Tiranë, 7 shtator 1962.

⁴⁷ FRUS, 1961-1963, vëll. V, dok. nr. 165.

⁴⁸ Sovjetikët - megjithëse pikërisht në ato javë, kishin ndërmarrë një valë të re sulmesh kundër Enver Hoxhës - duke iu druajtur pasojave, edhe politike, që mund t'i shkaktonte Shqipërisë një izolim i plotë ekonomik, i lanë të lirë satelitët e tyre t'i shkëpusnin ose jo marrëdhëniet tregtare me RPSH-në, të cilët (me gjithë protokollet tregtare me të gjitha vendet e zonës COMECON ishin rinovuar në muajt janar e deri në mars 1962) i mohuan kreditë, vonesat dhe klauzolat preferenciale, që më parë garantonin një shkëmbim të bazuar në kritere thjesht ndihmëse, pa i dhënë rëndësi një verifikimi cilësor të prodhimeve të marra, ndonëse të leverdishme po të kemi parasysh lehtësitë në pagesa. AMPJ, v. 1962, d. 47.

klime të pafavorshme i kishin shkaktuar vendit një krizë të vërtetë e të thellë ushqimore, nga e cila vetëm ashpërsia e sistemit shtypës e ndalonte të shndërrohej në revoltë⁴⁹. Kina mundej të mbulonte vetëm pjesërisht mungesat kronike të sistemit prodhues kombëtar: kreditë e marra për pesëvjeçarin 1961-1965 nuk ishin të mjaftueshme të mbulonin nevojat për të realizuar programin e industrializimit; për sa i përket pjesës tjetër, mbështetja e Pekinit dukej pak e frytshme, sepse u kufizua në ndihma që Shqipërisë i lejonin vetëm sa të mbijetonte dhe që popullata e saj të mos vdiste urie. Një iniciativë shumëpalëshe ndihme - një ide mjaft logjike e me një profil konceptual - përjashtohej, sepse mund të mos pëlqehet e pra të dështonte, sepse regjimi nuk kërkonte asgjë publikisht. Në kërkim të zgjidhjeve, *leadership*-i shqiptar - tek i cili, shënonte Gabrici, tashmë nervozizmi ishte ndjenja mbizotëruese - u detyrua t'u drejtohej tregjeve perëndimore: ambasadori italian tanimë vërente nisjen e shpeshtë të delegacioneve tregtare nga Tirana edhe drejt vendeve të largëta.

Falë marrëveshjeve të reja dypalëshe eksportet shqiptare në Itali u shtuan në masë të ndjeshme duke filluar nga viti 1962 (132%). Por që regjimi vazhdonte ta quante të pamjaftueshme: kufizimet e detyruara nga situata e veçantë politike e vendit, mungesa pothuajse e plotë e valutës së çmuar, prodhimet shqiptare me vlerë të paktë, sistemi primitiv prodhues, i paaftë të konkurronte në tregje, e vështirësonin gjendjen⁵⁰. Në Romë, si ambasadori Jordan Pani, ashtu edhe këshilltari Gjon Vangjeli në kontaktet e tyre të vazhdueshme me *Farnesina*-n kërkonin të bindnin

⁴⁹ Hysni Kapo, atëkohë anëtar me peshë të rëndësishme në KQ, u tregua habitshëm i sinqertë në raportin e paraqitur në plenumin e partisë në fund të tetorit të vitit 1962, ku deklaroi se "shtimi i prodhimit bujqësor (përfaqësonte) angazhimin kryesor ekonomik të vendit": pra po braktisej objektivi i përqendrimit të investimeve në sektorin industrial, i vendosur në Kongresin IV të PPSH-së vetëm një vit e gjysmë më parë, zëvendësuar nga një plan bujqësor i destinuar të zgjaste deri në vitin 1965. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 119, t. nr. 1334/744, Tiranë, 9 nëntor 1962; po aty, DGAP 1963, b. 21, t. ris. nr. 380/230, Tiranë, 27 prill 1963.

⁵⁰ AMPJ, v. 1963, d. 36.

qeverinë italiane të vepronte derisa të arrihej një perspektivë rritjeje e efektshme e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare mes dy vendeve⁵¹: fakti që vetë Hoxha u shpreh publikisht për një forcim të tyre tregonte sa urgjente ishte për regjimin nevoja për të gjetur rrugëdalje nga kjo situatë kritike⁵². Blerja nga ana e API-t e njëqind mijë tonë naftë të papërpunuar, mundësoi që në fund të vitit 1962 për herë të parë kursi i këmbimit të ishte në favor të Shqipërisë⁵³: një e dhënë politikisht tejet e rëndësishme dhe që për Gabrici-n duhej përforcuar në të ardhmen, edhe, sepse po rritej frika se vendet e tjera mund të hynin në konkurrencë me Italinë për të mbushur hapësirat e lëna bosh nga sovjetikët⁵⁴. Pra, duhej vepruar shpejt, por vendimi i *Farnesina*-s për ta shtyrë përfundimin pozitiv të negociatave tregtare deri në arritjen e një marrëveshjeje mbi transferimin e shumave të depozituara nga italianët pranë Bankës së Shtetit Shqiptar⁵⁵ dhe kujdesi i regjimit

⁵¹ Duke shqyrtuar mundësitë e rritjes së eksporteve shqiptare, Roma sugjeroi të prisnin deri më 15 dhjetor 1962 për shkëmbimin e *note di validita* të listave merceologjike në marrëveshjeje të vitit 1961. Tirana, përveç një sasive më të madhe hekuri e kromi, propozoi një listë të pasur prodhimesh për industrinë ushqimore, e cila, sipas Ministrisë së Tregtisë me atë të Jashtme dhe ICE-s, do të priteshin mjaft mirë në tregun italian. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 120, n. verb. nr. 42/25116/1145, Romë, 15 dhjetor 1962.

⁵² Po aty, b. 119, tel. nr. 100, Tirana, 31 maj 1962.

⁵³ AMPJ, v. 1963, d. 81.

⁵⁴ Në fakt, më 15 dhjetor të vitit 1962 francezët kishin nënshkruar një marrëveshjeje tregtare me shqiptarët, e para me RPSH-në (që datonte në vitin 1929). ASMAE, DGAP 1963, b. 21, l. ris. nr. 7, Gabrici Regard-it, Tiranë, 4 janar 1963.

⁵⁵ Çështja e përvitshme e parave, që regjimi u detyrohej italianëve, që u lejuan të largoheshin nga Shqipëria në vitin 1947, të cilëve u kërkonte, përpara se të niseshin, të depozitonin (shpesh me detyrim) kursimet e tyre në bankën e Shqipërisë - të bllokuara prej një kohe të gjatë për shkak të Shqipërisë që nuk po njihte në likuidim taksën e favorshme të shkëmbimit mes lekut dhe liretës që erdhi në fuqi menjëherë pas luftës - më në fund, mundi të konsiderohej e zgjidhur përmes një shkëmbimi notash me të cilat autoritetet shqiptare konfirmoi se autorizonin institutin e kredive të paguante drejtpërdrejt në dollarë shumat që u detyroheshin kredituesve italianë që kishin bërë kërkesë. Po aty, b. 21, n. verb. nr. 402/63, Tiranë, 13 korrik 1963; t. nr. 625/368, Tiranë, 20 korrik 1963.

- që prirej të niste fazat operative vetëm pasi të kishte përjashtuar çdo përpjekje për “kurthe”⁵⁶ - e vonoi deri në korrik të vitit 1963 nënshkrimin e protokolleve të reja⁵⁷.

Ky zhvillim pozitiv i marrëdhënieve ekonomike nuk i ngjallte shpresë qeverisë italiane se regjimi, duke u ndikuar nga ide të ndryshme, do të ndryshonte paksa idetë e një ortodoksie sterile pseudo marksiste-leniniste, mbrojtur me fanatizëm nga drejtuesit e tij, që mbështesnin kryesisht zgjatjen në pushtet të një regjimenti politik me synim mbijetesën e *leadershipit* të tij⁵⁸. Një ekuilibër i brishtë e shtrëngonte të mbante vazhdimisht një vijë ideologjike, e cila - megjithëse ishte tepër e vështirë të kuptohej nga vëzhguesit e jashtëm që nuk shpjegonin dot sesi mendimet e ndryshme mund të paragjykonin deri në atë pikë marrëdhëniet mes shteteve anëtare të kampit socialist⁵⁹ - në ata muaj doli e përshtatshme, të paktën për sa i përket direktivave të politikës së jashtme, për një

⁵⁶ AMPJ, v. 1963, d. 36.

⁵⁷ Bisedimet për përcaktimin e listave të reja merceologjike u zhvilluan në Tiranë në një atmosferë pozitive bashkëpunimi. Delegacioni italian - i udhëhequr nga inspektori i përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë me vendet e tjera, Benjamin Miozzi, - ku bënin pjesë përfaqësues të dikastereve të Punëve të Jashtme, të Thesarit dhe të Bujqësisë, si edhe të Ufficio Italiano Cambi, ra dakord me atë të RPSH-së, që drejtohej nga Thanas Gjoka, për një rritje prej 20% të prodhimeve shqiptare të shitshme në tregun e vendit. Në fund ftoi për një udhëtim në Itali një mision ekonomik për të vendosur kontakte me ndërmarrje italiane e që u prit menjëherë në mënyrë të favorshme nga regjimi. ASMAE, DGAP 1963, b. 21, tel. nr. 102, Tiranë, 9 korrik 1963; tel. nr. 105, Tiranë, 13 korrik 1963. AMPJ, v. 1964, d. 654.

⁵⁸ Në fjalimin programatik në Asambleenë popullore të 17 korrikut 1962 - që u mbajt jo pa qëllim pak javë pas misionit në Kinë të Hysni Kapos dhe Ramiz Alisë - Mehmet Shehu, i emëruar përsëri si kreu i qeverisë, ndonëse pa mohuar moralitetin, përshkroi një profil kritik të parimit të bashkëjetesës paqësore, duke theksuar se “imperializmi kapitalist, për shkak të natyrës së tij agresive”, duke përfutur nga ulja e tensionit dhe nga procesi i çarmatimit, instrumente të një “realizmi pacifist të dyshimtë”, do t’i përdorte ato për të modifikuar asetet shoqërore dhe ekonomike të vendeve socialiste, të dobësuara nga ndikimi revizionist, duke kërkuar edhe modele të integritimit ekonomik funksional, për të ushqyer iluzionet “përmes një joshjeje të lehtë” programesh bashkëpunimi dhe ndihme, nga të cilat mund të binin viktimitë edhe shtetet e reja të pavarura, prandaj dhe vëmendja e regjimit, në kërkim të “konvergjencave antiimperialiste”, në atë periudhë ishte intensifikuar shumë. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 118, tel. nr. 123, Tiranë, 17 korrik 1962.

⁵⁹ FRUS, 1961-1963, vëll. XVI, dok. nr. 127.

skënar të ndryshuar ndërkombëtar në të cilin Shqipëria dukej se po qëndronte në një pozicion *stand by*⁶⁰. Afrimi që po ndodhte mes jugosllavëve dhe sovjetikëve, gjendja zyrtare, e përhershme e luftës mes Tiranës dhe Athinës, mosinteresimi - i shoqëruar nga një skepticizëm i dukshëm - me të cilin aleatët reagonin ndaj nismave të Romës me RPSH-në⁶¹, e bënë të detyrueshëm një vlerësim të ri të politikës italiane për Shqipërinë. Mbi të gjitha ishte shqetësues qëndrimi i NATO-s, ku vetëm Turqia mbështeste - me pak sukses - idenë italiane të një veprimi më aktiv ndaj regjimit. Mjediset e të arratisurve shqiptarë këmbëngulnin se në Tiranë frika e shkaktuar nga vizita e ardhshme e Hrushovit në Beograd - e parashikuar në gusht të 1963-shit - ishte aq e madhe sa e kishte shtyrë qeverinë e saj t'u kërkonte në mirëbesim turqve të zgjonin në gjirin e Këshillit Atlantik interesin e fuqive perëndimore për çështjen shqiptare. Ankaraja, në të vërtetë, nuk e kishte të lehtë; për më tepër, sipas *Farnesina*-s, duhej shpresuar në një iniciativë të përbashkët italo-greke, me të cilën dy anëtarët e NATO-s, më afër me Shqipërinë, të mund të zyrtarizonin një lloj mbrojtjeje të përbashkët ndaj saj⁶².

Por, ishte tepër vonë. Acarimi i konfliktit ideologjik midis revizionizmit hrushovian dhe ortodoksisë maoiste i dha Hoxhës, të trembur nga mundësia se jugosllavët - me mbështetjen ose,

⁶⁰ Në këtë kuptim ngjallehin shumë shpresa nga hapja e ambasadës shqiptare në Vjenë, vendosja e marrëdhënieve me Algjerinë, Marokun dhe Kamboxhian, dërgimi i misioneve diplomatike dhe tregtare në Suedi, në vendet e Ulëta, në Ganë, në Irak, në Egjipt, në Sudan dhe në Brazil, udhëtimet në Shqipëri të organizuara për diplomatët indianë e madje dhe japonezë. ASMAE, DGAP 1961-1962 R, b. 120, t. sekr. nr. 687/356, Tiranë, 18 maj 1962; b. 121, t. nr. 719/374, Tiranë, 25 maj 1962.

⁶¹ Mosinteresim që rridhte edhe nga njëfarë vështirësie për të kuptuar në thellësi regjimin e Hoxhës. FRUS, 1961-1963, vëll. XVI, dok. nr. 19.

⁶² As nga Parisi nuk u arrit të merrej një mbështetje për të bindur komunitetin euroatlantik të zhvillonte iniciativa organike ndaj Shqipërisë, ndonëse vlerësimi që gjenerali Charles de Gaulle i jepte Tiranës, për politikën e saj antiamerikane, e trembte *Farnesina*-n se prestigji i lartë i Francës në atë periudhë të regjimit, mundej me kohë të ridimensiononte nivelin e marrëdhënieve me Italinë. ASMAE, DGAP 1964, b. 22, t. sekr. nr. 53/31, Tiranë, 25 janar 1964.

më saktë, me mosinteresimin e sovjetikëve - do të shfrytëzonin krizën e rëndë ekonomike që po kalonte vendi për të përmbysur regjimin, pretekstin për t'ia bashkangjitur fortësisht politikën e jashtme shqiptare asaj kineze⁶³. Mbërritja në Tiranë, më 31 dhjetor 1963, e Çu En Lait, kryeministër i RPK-së dhe zëvendëskryetar i Komitetit Qendror të PKK-së, që qëndroi dhjetë ditë, shoqëruar nga ministri i Jashtëm Çen Ji, përveçse baraspeshoi udhëtimin e Hrushovit në Jugosllavi, vulosi mes dy vendeve një identitet pikëpamjesh ideologjike dhe politike, i cili tashmë mund të konsiderohej i plotë. Në planin e imazhit regjimi doli veçanërisht i përforcuar, ndonëse kinezët - me njëfarë zhgënjimi nga pala shqiptare - parapëlqyen ta shtynin deri në marrëveshje të tjera rregullsinë e ndihmave në fushën ekonomike dhe ushtarake⁶⁴.

Nga ana tjetër, fakti se, pikërisht në sy të Çu En Lait, Mehmet Shehu pohoi se marrëdhëniet me Italinë ishin “normale” - në ndryshim për Greqinë dhe Jugosllavinë, të përcaktuara të “vështira” - dëshmonte se, pavarësisht periudhës jo të lehtë që kishte kaluar RPSH-ja, ishin arritur përmirësime të cilat, ndonëse dukeshin sikur ishin të parëndësishme, i hapnin rrugë zhvillimeve të ardhshme të kontakteve dypalëshe⁶⁵. Bashkëpunimi me vendet socialiste, armiqtësore ndaj revizionizmit, mbështetja ndaj popujve që luftonin kundër neokolonializmit, zhvillimi i një politike të fqinjësisë së mirë mbi bazën e respektit reciprok

⁶³ Emërimi, në tetor të vitit 1963, i një eksponenti të nivelit të lartë të regjimit, i zëvendësministrit Nesti Nase, si ambasadori i ri shqiptar në Pekin, u kuptua si një dëshmim i ri i përforcimit të marrëdhënieve me Kinën, vulosur nga nënshkrimi - më 6 dhjetor - i dy protokolleve që parashikonin një shtim të konsiderueshëm të shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve, me lëvrimin e një kredie të rëndësishme në favor të Tiranës. ASMAE, DGAP 1963, b. 22, t. nr. 850/494, Tiranë, 5 tetor 1963; t. nr. 1048/633, Tiranë, 13 dhjetor 1963.

⁶⁴ Në këto takime u përpunua një deklaratë e përbashkët, e shpallur në 9 janar 1964, e përqendruar në pjesën më të madhe të çështjet e politikës ndërkombëtare, në të cilën qëndrimi i Shqipërisë ishte qartazi i parëndësishëm; në të kundërt, të pakta e të përgjithshme ishin referencat rreth mundësive konkrete të zhvillimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Për tekstin shih: DGAP 1964, b. 23, t. nr. 34/23, Tiranë, 18 janar 1964.

⁶⁵ Po aty, b. 22, t. nr. 20/15, Tiranë, 10 janar 1964.

dhe të mosndërhyrjes ishin disa drejtime - tashmë të njohura nga diplomacia italiane - që synonin të përpunonin një dimension teorik të politikës së jashtme shqiptare, e paaftë të shpëtonte situatën ekonomike që mezi po mbahej në këmbë. Ndihma kineze nuk mundej aspak të përmbushte të gjitha kërkesat e vendit; shkëmbimet me zonën e COMECO-nit ishin kufizuar jashtëzakonisht shumë, por nuk dukej as ndonjë perspektivë e sigurt për të rifilluar marrëdhëniet tregtare me Greqinë dhe Jugosllavinë: kjo gjendje i krijonte mundësi Italisë për një hapësirë të gjerë veprimi, edhe ngaqë nuk krijohej konkurrencë me fuqitë e mëdha ekonomike, me të cilat RPSH-ja nuk mbante marrëdhënie⁶⁶. Tregu shqiptar ishte mjaft modest, por zhvillimi i ndërveprimeve sinergjike midis objektivave politikë të *Farnesina*-s dhe të iniciativës së ndërmarrjeve private do të mundësonte shkëmbimet mes dy vendeve, jo vetëm për të tejkaluar të dhënat shumë pozitive të regjistruara në vitin e mëparshëm, plus me një bilanc që - përsëri, megjithëse fare pak aktiv - duhej riekuilibruar për shkak të dëshirës së regjimit që synonte barazimin, por edhe për të fituar, përmes shkëmbimesh të përqendruara dhe të ekuilibruara, kufizimet e vendosura nga një sistem i penguar nga vështirësia për sigurimin e produkteve që, përmes ndërmarrjeve *Albimport* dhe *Exportal*⁶⁷, nuk përfshiheshin aq sa ishte vendosur nga organet sipërore për planifikimin ekonomik⁶⁸.

⁶⁶ Shembulli i Francës, që me blerjen e më shumë se 1000 tonë duhan, siguroi një seri kontratash të favorshme për furnizimet industriale, nxiti një reflektim në kancelaritë perëndimore: në Uashington, pikërisht në ata muaj Averell Harriman, nënkretar për Punët e Jashtme, u ngarkua të paraqiste një plan organik për përforcimin e tregtisë mes Shteteve të Bashkuara dhe vendeve socialiste, përfshirë edhe Shqipërinë. FRUS, 1961-1963, vëll. IX, dok. nr. 328.

⁶⁷ Për importet e mallrave italiane në Shqipëri ishte, gjithnjë dhe gjithnjë, e nevojshme të përcaktohej paraprakisht një financim, i cili mund të varej krejtësisht nga shitja e mallrave shqiptare të destinuar për eksport, duke mos qenë e parashikuar, nga marrëdhëniet tregtare mes dy vendeve, asnjë blerje.

⁶⁸ ASMAE, DGAP 1964, b. 22, t. nr. 42/4648/C, Romë, 6 mars 1964.

Në muajt prill dhe maj të vitit 1964 këtyre iniciativave ambicioze iu përgjigj në mënyrë pozitive, qëndrimi në Itali i një delegacioni të regjimit, i cili, falë koordinimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, hyri në kontakt me realitetet e rëndësishme të sistemit prodhues kombëtar⁶⁹.

Suksesi i këtij udhëtimi i lehtësoi negociatat për protokollin tregtar për vitin 1964, nënshkruar në Romë më 14 maj nga zëvendësministri, Vasil Kati, dhe nga inspektori i përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë me Jashtë, Carlo Gramaglia, që programoi një rritje prej 35% të vëllimit të shkëmbimeve në krahasim me një vit më parë⁷⁰, objektiv - më i ulët nga sa kërkohej nga pala italiane⁷¹ - që mund të arrihej më lehtësisht falë hapjes, kërkuar nga shqiptarët, të një zyre tregtare në Milano që, shtuar asaj të

⁶⁹ I drejtuar nga zëvendësministri i Tregtisë, Vasil Kati - shoqëruar nga funksionarë të dikastereve të qyteteve të ndryshme të Italisë Qendrore e Veriore (Milano, Venecie, Firenze, Romë), pati kontakte, edhe pranë stabilimenteve, me përfaqësues të shoqërisë civile (Riello, API, Montecatini, Pirelli, Necchi, Nuovo Pignone), të enteve parashtetërore (ENI dhe IRI), e instituteve bankare (*Credito Italiano, Banco di Napoli, Istituto Mobiliare Italiano, Banca Commerciale Italiana, Banca Nazionale del Lavoro, Banco di Roma*) dhe të shoqatave të kategorisë (*Confindustria*). Po aty, b. 22, t. nr. 50/5183/C, Romë, 22 prill 1964. AMPJ, v. 1964, d. 654.

⁷⁰ Listat e mallrave parashikonin një shkëmbim tregtar të një vlere më të madhe sesa shtatë miliardë lireta: për eksportet italiane parashikohej një shtim veçanërisht në sektorët kimikë, të kantierëve, të makinerive dhe të makinerive industriale, ndërsa shqiptarët do të shisnin në Itali sasi më të mëdha bitumi, leshi të papërpunuar, dru dhe produkte ushqimore. ASMAE, DGAP 1964, t. nr. 42/9773/C, Romë, 16 maj 1964. Më pak fat pati kërkesa për të sjellë në tregun e gadishullit kontingjente të rëndësishme duhani, prodhimi i të cilit destinohet nga regjimi në një pjesë të madhe për eksportet si shkëmbim për furnizimin e makinerive të shtrenjta. Për të kapërcyer kundërshtinë e ashpër të Monopoleve të Shtetit, që ishin ndeshur tashmë me Jugosllavinë, Bullgarinë, Greqinë dhe Turqinë për të njëjtën cilësi prodhimi, u desh të ndërhynte ministri i Tregtisë me Jashtë, Bernardo Mattarella, që i kërkoi përfaqësuesit të dikasterit të Financave, Roberto Tremelloni-t, “të ndreqte” planin e blerjeve të administratës duke përfshirë një kuotë rreth 500 tonë duhani shqiptar. Po aty, b. 22, l. nr. 54064, Mattarella a Tremelloni, Romë, 18 maj 1964.

⁷¹ Duke menduar një sistem pagesash të bazuara mbi kreditë, ishte parashikuar në fakt një rritje në krahasim me vitin e mëparshëm prej 100%. AMPJ, v. 1964, d. 665.

Romës, do të përsëritej edhe për në Trieste⁷². Shuma prej nëntë miliardë liretash, të fituara nga Montecatini për ndërtimin në Fier të një fabrike për prodhimin e plehrave kimike, transferimi (me pagesa për herë të parë të shtyra) shoqërisë së përzier *Colexim* të *know-how*-t për ngritjen në Kalimash të një impianti të nevojshëm për pasurimin e kromit, blerja e autobusëve FIAT, furnizimet e besuara të Edison-it, për industrinë e plastikës ishin të gjitha shfaqje të dëshirës së regjimit për t'u hapur vazhdimisht përtej ekonomisë, duke u përfshirë pjesërisht e për herë të parë në trekëndësja të ndërlikuar financiarë mes Romës, Tiranës dhe Pekinit.

Megjithëse RPSH-ja e kishte refuzuar disa herë propozimin italian për t'i përfshirë në një marrëveshje të përgjithshme të gjitha fushat e mundshme të bashkëpunimit⁷³ - duke nisur që nga programet e shkëmbimit dhe të ndihmës kulturore, më në fund, të zyrtarizuara në një marrëveshje në Romë më 6 qershor 1964, që do t'i jepte përsëri jetë asaj lidhjeje ideale që të dyja vendet kishin historikisht mes tyre⁷⁴ - kjo qasje e efektshme u mundësoi edhe marrëdhëniet dypalëshe të kalonin një fazë jashtëzakonisht pozitive, entuziaste, derisa më 23 korrik niveli i përfaqësive të tyre diplomatike u ngrit në rangun e ambasadave⁷⁵. Më në fund

⁷² Duke menduar një sistem pagesash të bazuara mbi kreditë, ishte parashikuar në fakt një rritje në krahasim me vitin e mëparshëm prej 100%. AMPJ, v. 1964, d. 665.

⁷³ AMPJ, v. 1962, d. 652. Shqiptarët ndiqnin një rrugë ekonomike që nuk iu krijonte probleme, por e cila, nga ana tjetër, nuk mundte të përballlej me pasojat politike që pa dyshim do të vijonin për shkak të këtyre marrëveshjeve. Po aty, v. 1963, d. 809.

⁷⁴ ASMAE, DGAP 1964, b. 22, app. nr. 31/19045, Romë, 20 qershor 1964. E gjeni, në këtë vëllim edhe të trajtuar nga Alberto Basciani.

⁷⁵ Propozimi, për t'i dhënë fund asaj që kishte mbetur si një përjashtim *a-storica* (dy legatat e fundit italiane jashtë shtetit ishin në Shqipëri dhe në Zelandën e Re), iu paraqit disa herë me radhë nga Gabrici, drejtuesve të lartë të diplomacisë shqiptare, të cilët njëzëri, e pranuan pa kundërshti të dukshme. AMPJ, v. 1964, d. 649 e d. 654.

regjimi u bind se Italia ishte më shumë burim sesa kërcënim: nga ana tjetër në Tiranë nuk fshihej më se gjendja ishte e rëndë. Raporti i paraqitur nga Ramiz Alia në KQ të PPSH-së në korrik - një autokritikë e vërtetë, pozitive e institucioneve para botës së punës të shoqërisë shqiptare - ishte një rast i humbur për t'i gjetur ilaçin në njëfarë mënyre një realiteti socio-ekonomik të mbushur tragjikisht me problematika mungese zhvillimi e paaftësie. Megjithatë - siç u shfaq qartazi nga deklaratat përmbyllëse të Hoxhës, i cili theksoi nevojën për të këmbëngulur “për intensifikimin e aksionit ideologjik drejt edukimit të thellë komunist” të popullatës, ku vlera morale e emulacionit socialist parapëlqehet gjithnjë ndaj të mirave materiale - regjimi nuk arriti të ndërmernte një qasje pragmatike për zgjidhjen e krizës me anë të reformave, të cilat, për fat keq, u hodhën poshtë, sepse u quajtën si të rrezikuara nga ndikimet revizioniste⁷⁶.

Duhej kuptuar nëse pranimi i faktorit kombëtar në komunizmin shqiptar - duke marrë parasysh gjendjen e vështirë ekonomike dhe konjunkturën e veçantë ndërkombëtare, pra, pas rënies së Hrushovit, më 14 tetor 1964, nuk ishte i qartë evolucioni - do ta shpinte RPSH-në drejt një izolimi të plotë ose drejt një ripërcaktimi të ngadaltë e të mundimshëm të direktivave të politikës së saj të jashtme. Në këtë rastin e fundit Italia do ta maksimizonte funksionin e saj të kontaktit, ose si “urë drejt Perëndimit” që edhe në Uashington shihej si me rëndësi strategjike, edhe më shumë në këtë moment kur politika e çtensionimit me fqinjët, e frymëzuar nga kryeministri i ri grek, Jorgos Papandreus, ngjallte shpresën se, më në fund, mund të arrihej në një normalizim të marrëdhënieve mes Athinës

⁷⁶ “Zakoni i vjetër i dembelizmit [...] prodhimitaria e ulët e punës [...] indiferenca ndaj pronës kolektive [...], keqpërdorimi i kuadrit direktiv”: me fjalët e Alias, komunizmi shqiptar, njëzet vjet pas marrjes së pushtetit, po e kuptonte se ndërtimi i socializmit nuk mund të bazohej te lindja e “njeriut të ri”, viktimitë e një “transformimi të botës subjektive”. ASMAE, DGAP 1964, b. 22, t. nr. 506/335, Tiranë, 22 korrik 1964; t. nr. 643/437, Tiranë, 14 shtator 1964.

dhe Tiranës⁷⁷. Por, nuk duhej kaluar - sipas *Farnesina*-s - në një naivitet si ai amerikan e të përfytyrohej se hapjet e shfaqura së fundmi nga regjimi mund të shndërronin marrëdhëniet korrekte ekzistuese me një pjesë të bashkësisë euroatlantike në një qasje *open minded* të çliruar nga paragjykimet ideologjike⁷⁸, edhe, sepse kështu në Tiranë do të lindnin dyshime që do ta shihnin Uashingtonin si një lloj dore drejtuese dhe frymëzues të politikës që Italia mbante ndaj Shqipërisë; në të vërtetë, ishte krejt e kundërta⁷⁹.

Paradoksalisht rënia e liderit sovjetik u përdor nga regjimi jo për t'u çliruar nga një kushtëzim kufizues, por për të përforcuar prestigjin e tij në vend: në festimet e njëzetvjetorit të çlirimit nga nazifashizmi, Hoxha më 28 nëntor 1964 nuk e shpalli veten fitues, por theksoi se lufta për mposhtjen e revizionizmit do të ishte ende e gjatë, duke përqafuar - e fortë kjo ide për sigurinë e rigjetur, që e forcoi agresivitetin e tij edhe më shumë - një mospërputhje të parashikuar ngjarjesh të zymta për të ardhmen e RPSH-së⁸⁰. Dashamirësia me të cilën Bashkimi Sovjetik, pavarësisht gjithçkaje, vazhdonte të shfaqte ndaj Shqipërisë dukej se nuk do të sillte asnjë rrjedhojë, sepse ishte e pamundur të hamendësohej, se një regjim i kapur nga një klan, që e kishte ngritur pushtetin e tij mbi besnikërinë ndaj stalinizmit dhe mbi luftën kundër titizmit, mund të vihej në diskutim përmes një rileximi kritik të së shkuarës së tij.

⁷⁷ Nuk përjashtohej aspak që - me gjithë kërkesën e vazhdueshme për njohjen e autonomisë së Epirit të Veriut - qeveria greke, pasi i përmirësoi marrëdhëniet me Bullgarinë dhe filloi traktativat për përforcimin e tyre me Jugosllavinë, po e shqyrtonte me frymë realiste çështjen e marrëdhënieve me Shqipërinë për shkak të krizës qipriote. Po aty, b. 23, t. nr. 2628/1036, Athinë, 15 tetor 1964.

⁷⁸ Gjithsesi, ringjalla e interesimit të Departamentit të Shtetit për Shqipërinë u përshëndet me kënaqësi nga diplomacia italiane. Po aty, b. 23, t. sekr. nr. 8484/3474, Uashington, 27 nëntor 1964.

⁷⁹ AMPJ, v. 1961, d. 471.

⁸⁰ ASMAE, DGAP 1964, b. 22, tel. nr. 210, Tiranë, 1 dhjetor 1964.

Mision i pamundur? Zgjerimi i diametrit strukturor të marrëdhënieve dypalëshe

Shpresa se pozicionimi i ri i RPSH-së brenda botës socialiste apo zhvillimet e ndodhura brenda Bashkimit Sovjetik mund të nxisnin një ndryshim në vijën ideologjike, madje dhe një ndryshim në drejtim, përëdoi përfundimisht në gjysmën e viteve gjashtëdhjetë: tepër e vështirë që qëndrimi izolacionist e jopërfshirës i regjimit të pësonte ndryshime me rëndësi në të ardhmen e afërt. I vetmi sektor ku mund të realizohej një veprimtari, e cila për të qenë produktive duhet të shqyrtohej edhe nën aspektin politik, ishte ai i tregtisë. Duke e lidhur Shqipërinë sa më shumë të ishte e mundur me sistemin ekonomik perëndimor dhe duke shfrytëzuar vështirësitë e shkaktuara nga detyrimet për të shlyer borxhet e marra vite më parë me satelitët sovjetikë, Italia do të kishte mundësinë - edhe pa nxitur iniciativa kulturore ose programe ndihme - që mund të ishin edhe jo të efektshme për të mbajtur të qëndrueshme praninë e saj përtej Adriatikut, duke pritur zhvillime ende të paparashikueshme. Këtij objektivi iu përgjigj traktati tregtar afatgjatë, i vlefshëm për trevjeçarën e viteve 1965-1967, nënshkruar në Tiranë, më 19 dhjetor 1964, i cili, përveç se rriti shkëmbimet mes dy vendeve në nivele të papërfytyrueshme deri pak vite më parë, u përpoq të baraspeshonte importet e munguara të duhanit nga Shqipëria, me sasi më të mëdha naftë, nikeli, kromi, bitumi dhe pambuku, duke njohur haptazi për herë të parë mundësinë nga pala italiane që të sillte në Shqipëri një ndihmë teknike në fushën e industrisë, të bujqësisë dhe shëndetësisë⁸¹. Doli një rezultat shumë pozitiv,

⁸¹ Carlo Gramaglia dhe Theohar Fundo, përfaqësues të të dyja ministrive respektive të Tregtisë. Nënshkruan edhe protokollin tregtar për vitin 1965, që e ngriti deri në 7.2 miliardë lireta vlerën e shkëmbimit të mallrave. Po aty, b. 22, tel. nr. 220, Tiranë, 19 dhjetor 1964. Sistemi i marrëdhënieve u mbyll me një shkëmbim notash që rregullonin pagesat. Për tekstin e marrëveshjeve shih, po aty t. ris. nr. 42/24887/C, Romë, 22 dhjetor 1964.

që e tejkaloi përmasën thjesht tregtare, edhe pse - si për vitin 1965, po ashtu edhe për vitin 1966⁸² - eksportet shqiptare, në të kundërtën e parashikimeve të regjimit, mbetën në nivele më të ulëta në krahasim me importet nga Italia⁸³.

Megjithatë, këto iniciativa vazhduan të përfaqësonin mënyrën më përfituese për të dhënë kontribut në zhvillimin e vendit dhe të marrëdhënieve dypalëshe në tërësinë e tyre, ndonëse Tirana gjatë gjithë vitit 1965 i refuzoi ftesat e italianëve që t'i ngrinin në nivel më të lartë marrëdhëniet me delegacione edhe politike e jo vetëm teknike⁸⁴. Marrëdhëniet mes dy vendeve po zhvilloheshin me rregullsi të admirueshme⁸⁵, por nuk duhej harruar se forcimi i raketave kundërvepruese, të vëna në veprim disa vite më parë nga Shtetet e Bashkuara në Pulje⁸⁶ - me gjithë tonet përgjithësisht pajtuese të Behar Shtyllës ndaj Romës në fjalimet e tij në parlament dhe të Jordan Panit në takimin me ministrin e Punëve të Jashtme, Amintore Fanfani më 2 gusht 1965 - e pengonte regjimin të çlirohej tërësisht, në ata muaj, nga ideja se Italia ishte mbi të gjitha një instrument i fuqisë ushtarake

⁸³ Shqiptarët u ofruan të hartonin kontrata afatgjata për furnizimin me hekur e nikel, që do të përpunoheshin në Pulje, në një stabiliment të ndërtuar enkas. Për sa i përket kromit, përkundrazi, regjimi pëlqente më shumë idenë e mundësisë së përpunimit të tij në Shqipëri, në një fabrikë të furnizuar me kredi të Italisë, gjë që parashikohej në programin ekonomik në zhvillim e sipër, duke përvijuar kështu një pronësi të përbashkët. AMPJ, v. 1965, d. 508.

⁸⁴ Po aty, d. 503.

⁸⁵ Pikërisht në këta muaj, në shenjë miqësie, zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Vasil Nathanaïli, e siguroi Gabrici-n se vendi i tij do ta mbështeste kandidaturën e Fanfan-it si president i Asamblesë së përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Po aty, d. 502.

⁸⁶ Shih, mbi këtë çështje: Philip Nash, *The Other Missiles of October: Eisenhower, Kennedy and the Jupiters 1957-1963*, The University of North Carolina Press, Chapel Hill-Londër, 1997.

amerikane⁸⁷, as të krijohej ndonjë mundësi e arsyeshme për të përmirësuar marrëdhëniet mes Tiranës, Uashingtonit e madje Londrës⁸⁸.

Gabrici - në raportin mbi misionin e tij të gjatë në Shqipëri, i cili përfundoi në prill të vitit 1966 - lë të kuptohet, në letrën dorëzuar Fanfani-t, një notë zhgënjimi që nuk kishte mundur të shtynte më shumë afrimin kryesisht politik mes dy vendeve (që ngjarjet në vitet e para gjashtëdhjetë kishin lënë të shpresohet), të penguar nga propaganda sovjetike (e prirë ta përshkruante RPSH-në si të gatshme “për t’iu shitur Perëndimit”), nga natyra e veçantë e regjimit dhe, në fund, nga prirja e tij për të theksuar në çdo rast “ekskluzivitetin” e marrëdhënieve me Pekinin: qëndrime që e kishin detyruar *Farnesina*-n të besonte se politikat e hapjes së Shqipërisë ishin shumë më të pakta nga sa ishte pritur. Megjithëse vëmendja e komunitetit ndërkombëtar ndaj Shqipërisë ishte zbehur në krahasim me periudhën dramatike të prishjes me BRSS-në, “rasti i veçantë shqiptar” për Italinë mbetej “një dukuri interesi specifik”, që mund të merrte rëndësi aktuale për aleatët në një moment të dhënë, kur brenda regjimit të vëreheshin turbullira⁸⁹.

Në këtë kuptim udhëzimet që iu dhanë ambasadorit të ri të Italisë, Norberto dell’Elmo Behmann-it, theksonin qëllimin e *Farnesina*-s për të ngulmuar në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike, meqenëse interesi i ndërsjellë për “fqinjësi të mirë”

⁸⁷ AMPJ, v. 1965, d. 501.

⁸⁸ Ftesat, në vitin 1966, që disa parlamentarë britanikë i bënë *Foreign Office*-it e që synonin mundësinë e rivendosjes së marrëdhënieve me Shqipërinë, nuk sollën përfundime pozitive, meqenëse Whitehall-i u deklarua “not likely (...) to take the initiative”. NA, FO 371/182535, rap. konf. *Diplomatic Relation with Albania*, Londër, 26 shkurt 1965.

⁸⁹ ASMAE, DGAP 1966, b. 1, rap. nr. 351, *Gabrici a Fanfani*, Tiranë, 23 prill 1966.